



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizimin e njeriut” të ndryshuar”. *(Komision për dhënie mendimi)*

2. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Klajdi Qama, Edmond Leka, Ilir Pendavinji, Kujtim Gjuzi dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Gjetan Gjetani, Halit Valteri, Andrea Marto, Lefter Koka dhe Zef Shtjefni.

Të ftuar:

Antoneta Njehrrëna – Drejtoreshë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Jolanda Hyska – Përfaqësuese e Instituti të Shëndetit Publik

Roland Kristo – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ledio Lollari – Inspektor i AKU-së

Hantin Bonati - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimjo Plaku – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Elson Thana – Specialist në MIE

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, datë 20.11.2019, ora 10:00.

Sot kemi vazhdimin e shqyrtimit, mundësisht votimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizimin e njeriut” të ndryshuar”. Relator është zoti Baraj.

Për këtë projektligj jemi mbledhur disa herë, ku kemi bërë dëgjuesën me grupet e interesit, ndërkohë kemi pasur edhe disa seanca me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të Ministrisë së Çështjeve Sociale dhe të Shëndetit Publik.

Ju kujtoj se çështja kryesore e diskutimit ka qenë shtrirja e efekteve të ndryshimeve në projektligj, pra të projektligjit të ri, i cili ndryshon ligjin e vjetër për të gjithë tregun e kripës në vend. Sipas projektligjit dhe ligjit të vjetër, si dhe këtij projektligji, ne i qëndrojmë jodizimit të kripës pothuajse me të gjitha llojet e produkteve, me disa përjashtime. Në mënyrë logjike përjashtohet përpunimi i ushqimeve për eksport, për shkak të rregullave në tregun e tyre, pra ka plot vende që nuk e kanë problemin e deficiencës së jodit, kështu që e lejojnë edhe përdorimin e kripës së pajodizuar për prodhimet që prodhohen këtu dhe eksportohen në ato tregje. Ne nuk kemi pse të vendosim të njëjtin regjim si për prodhimet tona. Ndërkohë, kemi diskutuar për dy amendamente, njëri nga zoti Baraj dhe një tjetër nga zoti Balla. Në amendamentin e zotit Balla ka një pikë, e cila ka hapur diskutime dhe sot duhet ta shterojmë në lidhje me listën përjashtuese të ushqimeve, që, përveç atyre të eksportit, të mund të tregtohen edhe në tregun vendas, sipas udhëzimit të një ministri apo dy ministrave relevantë. Këtu kemi pasur këndvështrime të ndryshme, por sot do ta ndajmë gjatë diskutimit dhe votimit. Kryesorja që na ka bërë të presim për të zhvilluar këtë seancë janë propozimet, rregullimet që presim të shqyrtojmë nga Ministria e Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë. Në lidhje me pjesën e kripës që prodhohet në vend, për shkak se projektligji forcon regjimin e kontrollit të inspektimit, monitorimit të kripës së importit, e cila mund të jetë 10%-15% e tregut, ndërkohë që për pjesën tjetër nuk ka asnjë ndryshim. Meqenëse ne marrim në shqyrtim këtë projektligj, atëherë është mirë që të prekim në mënyrë horizontale, të drejtë dhe të baraslarguar të gjithë kripën në treg, pavarësisht nga origjina.

Fjalën e ka relatori dhe më pas përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë për të prezantuar propozimet e reja, rregullimet e projektligjit dhe më pas të kalojmë te pyetjet dhe diskutimet.

Besnik Baraj – Unë e pashë draftin e ri të Ministrisë së Shëndetësisë dhe më duket se pjesa më e madhe i reflekton shqetësimet tona. Kështu që, për procedurë, mendoj të kalojmë në miratimin nen për nen. Pra, pa folur për një gjë të përgjithshme dhe më pas ta kalojmë; ose mund ta lëmë që ata të japin sqarimet e tyre në tërësi dhe më pas të kalojmë nen për nen, por ndoshta do të ishte më eficientë që të marrim nenin e parë, të shikojmë kontributin ri të ministrisë dhe më pas ta hedhim në votë, sidoqoftë si ta mendoni ju.

Niko Peleshi - Mendoj të bëjmë një prezantim të shkurtër pa i kaluar nenet një për një, sepse, me të drejtë, siç propozon relatori, do të jetë më eficiente që diskutimet e thelluara apo prezantimin tuaj të thelluar ta bëjmë, kur t'i vijë radha, te neni përkatës. Bëni një prezantim se ku fokusohen dhe se çfarë sjellin ndryshimet që ju propozoni me këtë draft të ri.

Antoneta Njehrrëna – Përshëndetje!

Jam Antoneta Njehrrëna, drejtoreshë Juridike e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Atëherë, nisur nga diskutimet e fundit në këtë komision, ministria mbajti shënimet e nevojshme dhe, bashkë me grupin e punës në ministri, nisur nga të gjitha shqetësimet që, me të drejtë, u ngritën në takimin e fundit ku ne ishim prezentë, u mbledh dhe vendosi që të bëjë një rishikim të draftit aktual të projektligjit. Në draftin e parë, që ishte sjellë nga qeveria dhe ishte propozuar nga Ministria e Shëndetësisë, ishin ndarë dy nene: neni 12 që lidhet me kontrollin e kripës së jodizuar dhe është shtuar një nen tjetër 12/1, në lidhje me kontrollin në pikat doganore. Gjykojmë si më të saktë dhe më korrekt mbledhjen në një nen të vetëm dhe riformulimin e nenit 12 aktual. Neni 12 aktual, sjell të re mënyrën e kryerjes së kontrollit në pikat e prodhimit. Ne kemi gjykuar se kontrolli i kripës së jodizuar në subjektet prodhuese të kripës së jonizuar të bëhet për çdo parti malli përpara hedhjes së saj në treg dhe ky kontroll të kryhet nga strukturat rajonale të shëndetësisë, duke përdorur laboratorët e saj të brendshëm.

Pjesa që lidhet me pikat e importit, do të jetë po e njëjta, thjesht është bërë saktësimi që do të jenë laboratorët e strukturave rajonale të shëndetësisë dhe do të bëhet po nga këto struktura. Pjesa e shpenzimeve për marrjen e mostrave vazhdon të ngelet njësoj dhe do të jetë për të dyja palët, pra si për strukturat, si për subjektet prodhuese, ashtu edhe për subjektet importuese.

Një ndryshim tjetër që kemi parashikuar në këtë draft të ri është për sa i përket pjesës së monitorimit të kripës së jodizuar. E kemi zgjeruar nenin, duke e sqaruar pak në pikën 2 të nenit pjesën e monitorimit. Çfarë është monitorimi?! Në bazë të propozimit, kemi thënë që monitorimi është procesi sistematik i mbledhjes së mostrave të kripës së jonizuar, analizimi dhe përdorimi të informacionit me qëllim sigurimin e niveleve të jodit në kripën e destinuar

për konsum njerëzor dhe shtazor dhe për përdorim në industrinë ish-ushqimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Gjithashtu, një tjetër propozim që kemi bërë, ishte zgjerimi i informacionit për gjurmueshmërinë dhe këtë e kemi bërë në nenin që lidhej me gjurmueshmërinë. Ne kemi zgjeruar informacionin që subjektet duhet të ruajnë për të siguruar gjurmueshmërinë e kripës së jodizuar, duke përcaktuar; përveç identifikimit të subjektit tregtar, personit fizik apo juridik, nga i cili operatori i biznesit ushqimor është furnizuar me kripë, identifikimin e çdo subjekti tregtar, të cilin operatori i biznesit ushqimor e ka furnizuar me kripë të jodizuar, sasinë e kripës së furnizuar dhe nivelin e jodit në momentin e furnizimit, si dhe datën e skadencës së kripës së furnizuar. Këto janë ndryshimet e reja që ne si ministri, pas diskutimeve në këtë komision, e kemi paraqitur për shqyrtim.

Niko Peleshi - Faleminderit!

A ka pyetje apo diskutime në lidhje me prezantimin, para se të fillojmë votimin?

Besnik Baraj – Kam vetëm shqetësimin në lidhje me atë që detyrohet vetë subjekti për çdo parti. Mos është ndonjë lloj diskriminimi. Unë nuk besoj se ato do t'i çojnë tek institucionet ndërkombëtare, por, duke pasur parasysh që ne jemi pjesë e marrëveshjes së CEFTA-s, e OBT-së, pra të mos trajtohet si një diskriminim që po i bëhet për këtë rast këtyre subjekteve, sepse risqet në produktet që importohen nga Bashkimi European, ekzistojnë gjithmonë. Unë e kam përmendur, qoftë për mytoksinat, qoftë për metalet e rënda veçanërisht te peshku, te konservat. Pra, po të ndiqet kjo logjikë, do të duhet që të ndiqet çdo parti e konservave dhe e të gjitha produkteve që vijnë, duhet të bëhen analizat përkatëse, sepse ato potencialisht janë kaq të rrezikshme edhe më shumë se sa vetë dobia që sjell përmbajtja e jodit. Thjesht e kam si shqetësim, por, në qoftë se ju e kaloni, për mua nuk ka ndonjë problem.

Antoneta Njehrrëna – Mendojmë se nuk ka një diskriminim, për aq kohë sa ne vendosëm që prodhuesit dhe importuesit t'i vendosim në të njëjtën mënyrë, pra importuesi, sa herë që e sjellë mallin në doganë dhe prodhuesi, sa herë që nxjerr një parti të re.

Besnik Baraj – Në qoftë se nga Bashkimi European vjen një mall, një produkt mielli, që, sigurisht, është i ekspozuar nga mykotoksinat, ai ta sjell që nuk ka mykotoksina dhe ti nuk e detyron që të bëjë analizë për çdo parti, ndërkaq detyron atë tjetrin, që vjen po nga Bashkimi European me përmbajtje jodi të certifikuar nga laboratorët e Bashkimit European. Kjo është.

Antoneta Njehrrëna – Qëllimi i vendosjes së kësaj është pikërisht fakti, se kripa e humbet jodizimin, në qoftë se nuk është transportuar apo ruajtur sipas kushteve të caktuara.

Historikisht, kjo ka qenë ajo kërkesa që, përveç asaj deklarates, që vërtet mund të jetë e prodhuar me kripë të jodizuar, të nevojitet...

Besnik Baraj – Në fakt, edhe në atë artikullin që ju tregova juve, në të gjitha rastet, kur transporti bëhet me ambalazhe që nuk kanë kapacitet absorbues, ose nuk janë hapur, praktikisht për 6 muaj kripa e ruan përmbajtjen e jodit në nivele të njëjta. Në qoftë se është me karton, në qoftë se është e hapur, atëherë po. Në qoftë se do të ishim skrupulozë, ne duhej ta specifikonim që do të kontrollohen vetëm ato parti, të cilat kanë një ambalazhim jokorrekt, janë rifuxho, por, po të vijmë në qese plastike jodi nuk humbet. Kjo është e provuar shkencërisht.

Niko Peleshi – Në rregull, këtë mund ta diskutojmë, kur të shkojmë te neni përkatës.

Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Në lidhje me shqetësimin e kolegut Baraj për diskriminim, në fakt, dogana ka disa praktika të tilla, në varësi të produkteve që ka. Pra, nuk konsiderohet diskriminim në raport me produktet e tjera. Në qoftë se për një produkt të caktuar, për vetë përbërjen që ai ka, kërkohet që të bëhet një kontroll i caktuar, sot kemi plot produkte të tjera që i nënshtrohen këtij regjimi në doganë. Kështu që ky është një nga këto produkte që ka një regjim të caktuar në doganë. E rëndësishme është ajo që tha përfaqësuesja e ministrisë, pra është njësoj për të gjithë.

Niko Peleshi – A ka produkte të tjera në doganë që kanë këtë regjim, pra që i nënshtrohen detyrimit të bëjnë analiza për çdo ngarkesë?

Ledio Lollari – Jam Ledio Lollari, inspektor pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Në lidhje me pyetjen e zotit Peleshi, mund t'ju them se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në pikat e inspektimit kufitar, pra për sa i përket regjimit doganor për produkte të caktuara, kryesisht produkte mishi apo produkte me origjinë shtazore, merr mostra për çdo ngarkesë. Kjo është e përcaktuar edhe me udhëzim të posaçëm..

Niko Peleshi – Në rregull, e kemi diskutuar edhe herën e kaluar, pra, me udhëzim për një periudhë të caktuar, për një produkt që ka rrezikshmëri, mund të jetë edhe sezonale, kjo është e kuptueshme, por që të jetë taksative në ligj që për një produkt të caktuar në çdo ngarkesë t'i merret mostra dhe t'i bëhet analiza, nuk e di mos është pak e ekzagjuar? A ka produkte të tjera që e kanë këtë regjim që me detyrim duhet t'u bëhet analiza? E drejta dhe detyrimi janë dy gjëra të ndryshme. Pa dyshim, që të drejtë ka AKU-ja dhe institucionet e tjera që për çdo ngarkesë, sa herë të duan dhe sa herë ta gjykojnë me risk, të marrin mostër, por për ta detyruar me ligj nuk e di.

Urdhëroni!

Robert Bitri – Për sa u përket këtyre produkteve të tjera që kontrollohen në doganë, ka një standard. Përgjithësisht produktet, që vijnë nga vendet e BE-së, kanë një risk më të ulët dhe kontrollohen shumë më pak, kurse vendet e tjera që janë të klasifikuara me risk më të lartë, në bazë të përcaktimit nga ana e ministrit të Bujqësisë kontrollohen më...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për shembull, mishi që vjen nga Brazili, bëhet me urdhër ministri.

Niko Peleshi – Në rregull, por jo me ligj.

Robert Bitri – Me urdhër ministri, sepse Brazili konsiderohet në nivel të lartë, por mishi që vjen nga vendet e Bashkimit European, me certifikatat e Bashkimit European, përgjithësisht nuk kontrollohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ne po flasim për ta fiksuar në ligj. Me akt nënligjor ministri e ka gjithmonë të drejtën kur e vlerëson me risk origjinën, sezonin apo llojin e produktit. Mund të kërkojë që të merret mostër për çdo ngarkesë. Pra, e ka këtë të drejtë, nuk ia heqim ne me këtë ligj. Ne me këtë ligj, përveç të drejtës, i japim edhe detyrimin, pra duhet detyruar apriori çdo institucion për kripën e jodizuar, pavarësisht nga vendi ku vjen, pavarësisht se sa është shkalla e riskut të bëjë analizë për çdo ngarkesë. Kjo është pyetja ime: a kemi ndonjë precedent tjetër?

Ledio Lollari – Në pjesën tonë, jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Në rregull, për ta ditur, më pas kur të vijmë te neni, do të diskutohet dhe do të votohet nga deputetët.

Urdhëroni, zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit edhe administratorëve të Ministrisë së Shëndetësisë!

Këtu te neni 4 i riformuluar thuhet....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, kur flasin akademikët, në heshtim.

Niko Peleshi – Në rregull

A ka pyetje apo diskutime të tjera?

Kujtim Gjuzi – Ta tregojmë se unë jam që të qeverisin akademikët.

Niko Peleshi – Në rregull, kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.6.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizimin e njeriut” të ndryshuar”.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në diskutimin dhe votimin nen për nen.

Ju lutem, mbajeni përpara draftin e Këshillit të Ministrave, sepse do të punojmë mbi atë draft! Ndërkohë, keni edhe tabelën me propozimet e reja të ministrisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 1 parashikon zëvendësimin e “Ministria e Shëndetësisë” me “Ministrinë përgjegjëse për Shëndetësinë”. Ndërkohë që te neni 1 kemi edhe një propozim të ri nga ministria, ku thuhet: “Përveç tekstit që kemi në nen të shtohet edhe inspektorati që mbulon fushën e shëndetit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është inspektorat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, si bëhet neni 1?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, neni 1 propozohet të bëhet: në të gjithë përmbajtjen e ligjit emërtimet ministria i/e Shëndetësisë” zëvendësohet me “ministri/ ministria përgjegjës/e për shëndetësinë” dhe “inspektorati që mbulon fushën e shëndetit” zëvendësohet me “struktura përgjegjëse që mbulon inspektimin në fushën e shëndetit”.

A jeni dakord Ministria e Bujqësisë dhe AKU-ja?

(Diskutime pa mikrofon)

Roland Kristo – Tani po rishikohet ligji për ushqimin, si edhe ligji për inspektoratin shëndetësor dhe shumë kompetenca të një pjesë të inspektoratit të shëndetit do t’i marrë AKU-ja, së bashku me një pjesë të personelit të tyre, pasi i qëndrohet parimit që në një biznes nuk mund të venë tre inspektorë...

Niko Peleshi – Dakord, këtë e dimë, por në qoftë se lihet kështu, siç e ka propozuar ministria, AKU-ja përjashtohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Sot e kemi “inspektorati” dhe ka një ligj që thotë ligji për ISHSH-në. Rregullimi i propozuar, struktura përgjegjëse që mbulon inspektimin këtu është gjenerike dhe

çfarëdo që të vijë mbrapa, në ISHSH apo AKU, apo edhe në ndonjë institucion tjetër do të ketë dikush inspektimin për shëndetin në mision.

Struktura përgjegjëse që mbulon inspektimin...

Niko Peleshi – Jo, e ka gabim, por mund ta kem edhe unë gabim, se këtu thuhet “inspektimi në fushën e shëndetit”, kurse AKU-ja me përkufizim nuk është autoriteti i kontrollit të shëndetit.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë jam dakord që “inspektorati” të zëvendësohet me “struktura”, por çështja duhet të jetë “e shëndetit” apo duhet të themi “shëndetit ose ushqimit”...

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – U tha se reforma e ardhshme kërkon që subjekti të mos inspektohet nga 2-3 trupa të ndryshme, pra thelbi është administrativ. Nuk ndryshon nevoja që duhet të ruajmë edhe ushqimin, edhe shëndetin; duhet të ruajmë edhe sheqerin, që nganjëherë na e dëmton ushqimin; duhet të ruajmë edhe kripën, që nganjëherë na e dëmton ushqimin; duhet të ruajmë edhe alkoolet pa alkool metilik, që nganjëherë na e dëmtojnë shëndetin. Se kush do të marrë kompetencën dhe çfarë instrumentesh do të përdorë, ne nuk e dimë sot, po ky problem është problem shëndeti, sepse nga kripa e parodizuar janë krijuar deformime të moshat e reja dhe kjo nuk ndryshon. Halli është po ai.

Niko Peleshi – Atëherë, supozojmë që projektligji do të vijë këtu (nuk do të miratohet). Ky ligj miratohet, kalon në seancë dhe hyn në fuqi. Sipas këtij ligji, AKU-ja nuk ka të drejtë të kontrollojë jodin. Duhet të jeni koshtentë se po i heqim AKU-së një të drejtë që e ka sot.

Në qoftë se ju mendoni se duhet t’ia heqim këtë të drejtë AKU-së, hajde të diskutojmë dhe hapet debat i madh, sepse AKU-ja me përkufizim sot ka të drejtë të inspektojë, të kontrollojë çdo produkt, i cili shkon për ushqim dhe nuk mund t’i heqim kripën, e cila përdoret për ushqim dhe t’i themi, ti je autoriteti i ushqimit, por këtë ushqim nuk ke të drejtë ta kontrollosh.

Ilir Beqaj – Po e përdor thjesht për ilustrim këtë. Përdërisa quhet ushqim, AKU-ja ka të drejtë të kontrollojë çdo detaj që ka këtu, nuk ka rëndësi çfarë është, po të jetë pjesë e ushqimit.

Te ky ligj pamjaftueshmëria e jodit dhe thelbi i kësaj nuk është kontrolli në doganë, por është monitorimi i të gjitha gjurmueshmërisë, sepse ky lloj komponenti edhe në kohë fillon e zbehet dhe kjo është arsyeja që jodin duhet ta ketë një strukturë për shëndetin. A e ka

nesër AKU-ja, a e ka pasnesër ISHSH-ja apo e ka një institucion tjetër, kjo është çështje administrative.

Problemi këtu nuk është vetëm matja statike një moment, por është gjithë sistemi i monitorimit dhe ky ligj këtë ka në thelb.

Niko Peleshi – Në qoftë se i bëjmë këtë riformulim, AKU-ja përjashtohet, sepse nuk është inspektorat shëndeti.

(Diskutime pa mikrofon)

AKU-ja e ka pasur të drejtën dhe, logjikisht, duhet ta ketë gjithmonë të drejtën të inspektojë, të kontrollojë, të monitorojë edhe gjurmueshmërinë e cdo lloj produkti, i cili përdoret në ushqim dhe, në qoftë se përdohet në ushqim, kjo gjë nuk mund të ndodhë, për shembull, ti mund të kontrollosh ujin, por jo magnezin. Pra, në qoftë se AKU-ja ka komptencë të kontrollojë një produkt, do të thotë se ka të drejtë të kontrollojë etiketën e produktit dhe ka të drejtë t'i kërkojë subjektit që atë që ka të shënuar në etiketë, në ato raporte ta ketë edhe përbërjen. AKU-ja si autoritet kombëtar ushqimi nuk mund të ketë kufizime.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë mendoj se duhet të jetë gjenerike ose të thuhet “inspektimi në fushën e shëndetit dhe/ose ushqimit”.

Urdhëroni, zonjë!

Antoneta Njehrrëna – Për të sqaruar diçka, theksoj se ligji ka qëllim të parandalojë çrregullimet e shkaktuara nga jodi. Pra, i gjithë qëllimi i ligjit është te pjesa e jodit, sepse është gjetur kripa si produkti që mund të eliminojë këtë pamjaftueshmëri jodike që ekziston në vendin tonë.

I gjithë thelbi i ligjit është ngritur për mbrojtjen e shëndetit, kështu që sigurisht, ky do të jetë inspektorati që mbulon fushën e shëndetit. Nëse kjo kompetencë lidhur me shëndetin do të jetë nesër te AKU-ja apo sot te shëndetësia, kjo është një çështje që nuk i takon aktualisht. Ne kemi një inspektim në fushën e shëndetit...

Niko Peleshi – Më falni! Në qoftë se AKU-ja do të përjashtohet nga çështjet që lidhen me shëndetin, AKU-ja nuk duhet të ekzistojë, sepse edhe kontrolli i ushqimeve ka lidhje me shëndetin publik indirekt.

Antoneta Njehrrëna – Nuk përjashtohet AKU-ja. Siç është shpjeguar edhe në të gjitha takimet që ne kemi bërë, AKU-ja në qoftë se e shikon kripën si ushqim, niveli i jodit për kripën, edhe nëse është nën 20 miligramshin që është përcaktuar nga ligji, ai konsiderohet ushqim i sigurt, por për shëndetësinë kjo nuk është...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ben, duket sikur logjikisht keni të drejtë, por po që se e krijojmë këtë precedent këtu, është një tronditje shumë e madhe për të gjithë fushën e veprimtarisë së AKU-së.

Po marr një rast tjetër, për shembull bukën, që është ushqimi më i ndjeshëm, por edhe me më shumë pikëpyetje dhe dyshime në treg (nuk po hyj në detaje se sa i drejtë është ky alarm apo panik te konsumatori, sepse është çështje tjetër), pra ka shumë ndjeshmëri, ka ndjeshmëri te çmimi, ka ndjeshmëri cilësia sepse përdoret çdo ditë në çdo vakt e të tjera.

Tani, te buka ne kemi një parametër, që fatkeqësisht është i vetmi, proteinën. Në qoftë se proteina e miellit është nën 12,5%, atëherë nuk lejohet që ky miell të përdoret për bukë (jo për arsye shëndeti, sepse në tregun jashtë, Francë, Gjermani, ke edhe bukë me 7%, apo biskotat që mund ta përdorin edhe me 9% proteinë), pra nuk është çështje shëndeti, por është një parametër që ka lidhje me cilësinë e bukës, por jo se cenon shëndetin e njeriut.

(Diskutime pa mikrofon)

Sipas kësaj logjike, duhet që AKU-ja të mos ketë të drejtë të hyjë as te buka? AKU-ja kontrollon çdo ushqim dhe nuk përdor logjikën për përbërësit e ushqimit, për të thënë që ky përbërës nuk është i dëmshëm, kështu që edhe po të jetë me pakicë, unë po i mbyll sytë, ndërsa ky është i dëmshëm dhe unë do të merrem me këtë, sepse është në kompetencën time. AKU-ja notifikon etiketën, themi ne, pra etiketa është ajo ku varet AKU-ja. Çfarë ka në etiketë, AKU-ja është e detyruar të kërkojë që produkti ta ketë edhe brenda, pa hyrë në analiza logjike. Kush dëmton dhe kush nuk dëmton shëndetin.

Urdhëroni, zoti Baraj!

Besnik Baraj – Unë bashkohem me idenë e zotit Niko. Do të jepja një shembull tjetër, në fakt, duke theksuar se kemi produkte ushqimore që lidhen drejtpërdrejt me shëndetin e njeriut dhe po të përdoret kjo logjike që thoni ju, atëherë ne duhet t'i heqim edhe produktet e tjera që nuk duhet t'i analizojë AKU-ja për shkak se janë subjekt i ministrisë suaj, problematikë e që trajtoni ju si ministri.

Unë nuk shoh asnjë të keqe që ju bëni punën tuaj, por kurrësi AKU-së të mos i hiqet kjo, se është një precedent, se mund të kërkojnë, për produkte të tjera, në mënyrë të ngjashme, që të hiqen.

Sipas riskut, AKU-ja, e analizon dhe ky është problemi i saj. Ju doni ta bëni në çdo parti, bëjeni! Në këtë rast ju duhet të gëzoheni, sepse ka një kontroll të dyfishtë. Ju e bëni në mënyrë permanente.

Unë jam i mendimit që të pranojmë propozimin e zotit Peleshi.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi – Këndvështrimi im është që, për aq kohë sa ministria përgjegjëse e ka konstatuar këtë problem, i mbetet asaj ta kontrollojë dhe të masë parametrat se si do të vijë ky jod te qytetarët. Ne nuk themi që ta përjashtojmë AKU-në nga kontrollet e veta, por për këtë specifikë, i takon Ministrisë së Shëndetësisë. Le të bëjnë një pjesë paralele, nëse më lejojnë administratorët, që për çdo bar që vjen në doganë, është Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave, ku duhet të prezantohet dokumentacioni i certifikuar që vjen nga BE-ja apo vende të tjera.

Në këtë kontekst, për aq kohë sa unë kam qenë atje, nuk kam hasur sistemin e korrupsionit.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Beqja!

Ilir Beqaj – Çfarë kërkon neni 1? Si është aktualisht? Aktualisht është “inspektorati që mbulon fushën e shëndetit” dhe me këtë përkufizim që kemi sot, a lejohet AKU-ja ta bëjë?

Me sa po thuhet, lejohet. Atëherë, çfarë duam të bëjmë? Nuk është më inspektorati që mbulon fushën, por është struktura përgjegjëse që mbulon inspektimin. Këtë po ndryshojmë.

(Diskutime pa mikrofon)

E kemi “struktura përgjegjëse që mbulon inspektimin në fushën e shëndetit”, pra “fushën e shëndetit” nuk ndryshon. Ndryshon kapistalli, prandaj është spekulim ajo që the, Besnik. Nuk preket çfarë është sot, pra fusha e shëndetit është në këtë ligj dhe ngelet në këtë ligj

Në qoftë se kjo fjali, si ç’është e shkruar në gjuhën shqipe, nuk ia ngushton kompetencat AKU-së. Nuk marrim vesh fare nga bujqësia apo shëndetësia, por jemi njerëz që marrim vesh gjuhën shqipe. Kjo fjali në gjuhën shqipe “inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, e zëvendësuar me struktura përgjegjëse që mbulojnë inspektimin në fushën e shëndetit është e njëjta gjë. Ka vetëm një lehtësi që kur të vijë ligji i ri, ne të mos kthehemi përsëri tek ky ligj.

Besnik Baraj- Megjithatë me sa vura re këtu nuk bëhet fjalë për asnjë spekulim, por për një kontroll të dyfishtë. Por nga ministria kërkohet që ta kenë këtë vetëm në autoritetin e tyre dhe përjashtojnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, një minutë!

Si prononcohet përfaqësuesja e ministrisë? AKU-ja të mos ketë të drejtën të bëjë këtë lloj kontrolli. Nëse është kështu, unë nuk jam dakord.

Niko Peleshi - Më falni!

Para se të marrë fjalën zëvendësministri, nuk dua të spekuloj edhe me pozicionin për ta marrë fjalën me shpesh se sa ju. Besoj se e keni vënë re këtë gjë, e marr fjalën më pak sesa të tjerët. Ky sindromi “siç ka qenë, duhet të jetë”, për mua nuk është i saktë. Nëse në projektligj ka qenë *ambigue* apo përjashtues, siç e lexoni ju, me shumë të drejtë, përderisa tani po marrim përsipër të rregullojmë ligjin atëherë hajdeni ta rregullojmë! Sipas interpretimit që bëri drejtoresha, i bie që e gjithë veprimtaria e AKU-së deri më sot, kur është marrë me kripën e jodizuar, ka qenë në kundërshtim me ligjin. Këtë po thotë zonja, këtë po thoni edhe ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja po e shpjegoj unë.

Të lutem, ta mbaroj fjalën!

Gjithmonë ka pasur debat ndërmjet AKU-së edhe inspektoratit në fushën e shëndetësisë pikërisht për atë se : “Ku fillon e drejta ime, ku mbaron e drejta jote”. AKU-ja edhe kur nuk është përmendur në ligje, si ky për shembull, që është përjashtues është bazuar te ligji i tij “Për ushqimin” dhe thotë: “Unë jam Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, çdo gjë që hahet, kam të drejtë ta kontrolloj” dhe është në të drejtën e tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk kam asnjë konflikt interesi.

Nuk ka lidhje me të qenit ish-ministër, përkundrazi. Nëse ka arritur Shqipëria aty që ish-ministrat të mbrojnë ngjyrat e ministrisë edhe kur ikin, atëherë do të thotë se jemi shumë larg.

Ilir Beqaj - Te Shëndetësia mos e merrni shumë për bazë, se po të kisha qenë i mirë më kishin mbajtur.

Niko Peleshi - Kurse të Bujqësia, mua më merrni për bazë, sepse nuk është e thënë se po të jesh i mirë, nuk duhet të rrish.

Fjalën e ka zoti zëvendësministër. Do të doja edhe një prononcim nga përfaqësuesi i AKU-së, se ndoshta ne jemi gabim.

Ledio Lollari - Unë do të bëj thjesht një sqarim. Si është sot situata? Bizneseve u 1, 3 apo 33 inspektorate që u trokasën në derë. “Unë do të marr mostër për këtë, për atë”. Qëllimi është që të ketë vetëm një dorë, ose minimalisht të reduktohet numri.

AKU-ja kontrollon kripën. Pse? Për metalet e rënda, mos ka elementë të tjerë përveç NaCl-së, nivelin e lagështirës. I thua: “Mos u merr me jodin, se do të vijë një tjetër institucion dhe do të merret me të, nëse është 100% kripë, ke shmangur doganën apo jo”. Duhet të ketë një institucion që ta lehtësojmë biznesin, të mos shkojnë 15. Ajo që duam, apo

ajo që qeveria po bashkon kompetencat, po bashkon një pjesë të kompetencave të Inspektoratit të Shëndetësisë duke ia kaluar AKU-së, bëhet që të mos shkojnë dhe të trokasin në dyert e bizneseve 15 inspektorate, 15 struktura, ku gjithsesi bën mostrën e tij.

Niko Peleshi – Besoj se jemi të gjithë dakord për këtë gjë, por mendoni sesi duhet të jetë një formulim më i përgjithshëm, që të mos jetë përjashtues dhe t'u paraprijë edhe ndryshimeve ligjore në kuadrin e inspektimit dhe të kontrollit.

Po, zoti Bitri.

Robert Bitri - Duke marrë fillesën e historisë së asaj që treguat ju, do të thotë se këtu të gjithë kohën ka pasur një kontradiktë se kush do ta kontrollojë. Meqenëse ligji e ka pasur këtë kontradiktë, zoti Beqaj do që ta vazhdojmë këtë kontradiktë. Fakti që ne duam ta ndryshojmë tregon se duam t'i përfshijmë të dyja institucionet nesër, por sot nuk duhet të përjashtojmë asnjë. Jam për t'i futur që të dyja institucionet. Nuk duhet të themi: “ Vetëm të shëndetit”, por të gjejmë një fjalë që t'i përfshijë të dyja palët, edhe AKU-në, edhe inspektoratin për të kontrolluar problemin, edhe të jodit, edhe për çfarëdolloj problemi tjetër. Për jodin të mos përjashtohet AKU-ja, sepse ajo është brenda pjesës ushqimore. Unë kështu e gjykoj.

Niko Pelshi - Fjalën e ka përfaqësuesi i AKU-së.

Ledio Lollari - Për të saktësuar më tepër veprimtarinë e AKU-së, ne i trajtojmë subjektet ku tregtohet, shpërndahet apo prodhohet produkti i kripës, si subjekt ushqimor. Por kur konstatohet mangësia e jodit, për hir të së vërtetës AKU-ja në asnjë rast nuk ka marrë masë administrative për mungesë jodi, por me shkresë përkatëse i është përcjellë kompetenca Inspektoratit Shëndetësor. Kjo gjë është bërë për të pasur ura bashkëpunimi në emër të ligjit.

Niko Peleshi - Ura bashkëpunimi po, por me këtë ligj, ju përjashtoheni, nuk keni absolutisht të drejtë. E ka bllokuar në doganë për mungesë jodi. Nëse është gabim, nuk do të thotë të vazhdojë si i tillë, përndryshe pse po bëjmë një draft të ri?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Njehrrëna – Mund ta sqaroj qëllimin fillestar pse është bërë ky ndryshim nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Aktualisht po krijohet një agjenci, e cila do të konsiderohet Agjencia e Sigurisë së Cilësisë Shëndetësore në shërbimin shëndetësor dhe do të bashkojë tri institucione. Në këto kushte inspektorati nuk do të jetë më një inspektorat. Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim, Agjencia Kombëtare e Cilësisë dhe Akreditimit, institucion i kujdesit shëndetësor, si dhe inspektorati. Në këto kushte dilte si domosdoshmëri që të mos përdornim më termin “ inspektorat”, por të themi “struktura shëndetësore” që

mbulon fushën e shëndetit. Kjo nuk krijon asnjë lloj ekuivoku. Për pamjaftueshmërinë jodike, do të jenë përgjegjëse institucionet përgjegjëse për shëndetin. Nëse shtojmë fjalët “edhe ushqimit”, atëherë mund të krijojmë një konfuzion. Nëse deri tani AKU-ja bënte kontrollin e saj për shkak se kripa është ushqim në bazë të legjislacionit për ushqimin, siç e tha edhe kolegu nga AKU-ja që pjesën e jodit e kalonte për kontroll në strukturat shëndetësore, mendoj se me këtë ndryshim nuk krijohet asnjë ekuivok, por sqarohet fakti që inspektimi në fushën e shëndetit do të vazhdojë për sa i përket pjesës së pamjaftueshmërisë jodike.

Niko Peleshi – Po, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi - Faleminderit!

E nderuar drejtoreshë, unë jam subjekti, marr këtë kripën dhe do të hyj në doganë. Ju do të vini dy palë atje? AKU-ja më vete? A mund të ma sqaroni këtë situatë?

Antoneta Njehrrëna - Aktualisht, marrja e mostrës në pikat doganore është kryer nga strukturat shëndetësore. Edhe në këtë ligj me rregullimet e reja që propozojmë marrja e mostrës për matjen e nivelit të kripës është detyrim i ligjit “Për jodin” dhe është kryer nga strukturat rajonale të shëndetësisë. Nuk është kryer asnjëherë nga strukturat e AKU-së apo të Ministrisë së Bujqësisë.

Niko Peleshi – Sot lejohen dy, përsëri do të vazhdojnë dy, nëse do të ndryshohet kështu siç po propozojmë ne.

Robert Bitri – Zoti kryetar, e tha përfaqësuesi i AKU-së që edhe ata shkonin dhe bënin kontroll. Pastaj thërrisnin përfaqësuesit e shëndetësisë për të parë jodin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arsyeja që tregoi Niko kjo ishte, që ai nuk kishte të drejtë ta kontrollonte nga këndvështrimi i jodit. Tani këtë përgjegjësi që i jep sot ligji AKU-së, nuk të lejon ty të kontrollosh për jodin apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, monitorim, por kontroll.

Niko Peleshi - Bllokimi i një ngarkese në doganë, a nuk quhet masë administrative? Sapo thatë që nuk keni marrë asnjë masë administrative për jodin. A ka raste kur AKU-ja ka bllokuar ngarkesa në doganë për kripën e pajodizuar, për shkak se ka qenë e pajodizuar?

Ledio Lollari - Po.

Niko Peleshi - Kjo është masë administrative.

Ledio Lollari - Po, pasi quhet produkt ushqimor dhe kjo është çështja që duhet të përmirësohet, ashtu siç e thatë edhe ju. Krijohen inspektime të dyfishta dhe barriera për subjektet.

Niko Peleshi – Çfarë propozoni? Si mendoni të jetë formulimi në draft?

Ledio Lollari - Formulimi duhet që autoriteti të jetë Inspektorati përgjegjës për Shëndetin dhe Ushqimin.

Antoneta Njehrrrena - Përsëri dy vetë do të shkojnë.

Niko Peleshi – Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi - Ne sot jemi duke diskutuar ndryshimet në ligj, të cilat kanë të bëjnë me pamjaftueshmërinë e jodit në organizmin e njeriut. Në këtë ligj përfshihet Inspektorati i Shëndetit. Nëse do të bëjmë fuzionin midis dy institucioneve, do të na vijë ligji që rregullon marrëdhëniet e AKU-së. Do të bëjmë edhe atje ndryshime në një moment të caktuar. Do të na vijë apo jo? Pra, mund ta marrim parasysh atje këtë gjë? Sot kështu e kemi.

I jap të drejtë kryetarit kur thotë se nga eksperiencia na ka ndodhur që në doganë kemi pasur përplasje. Ne po i diskutojmë këto probleme. A mund ta zgjidhim këtë përplasje? Ky është qëllimi i diskutimit.

Ilir Beqaj - Propozimi që u bë, është që të sanksionohet përplasja.

Arben Pëllumbi - Qëllimi është që të mos shmangim kontrollin e një enti apo të një institucioni ndaj një produkti, i cili është ushqim. Kemi thënë në mënyrë taksative se do të kontrollohet “çdo ngarkesë”. Çdo ngarkesë do ta kontrollojë AKU-ja dhe Inspektorati i Shëndetit për sa kohë janë veç apo do ta kontrollojë vetëm Inspektorati i Shëndetësisë dhe AKU-ja nuk do të përfshihet fare?

Ilir Beqaj - Me këtë propozim Inspektorati i Shëndetësisë...

(Ndërprerje e incizimit)

Niko Peleshi - Më falni!

Së pari, ta marrim nga qëllimi i ligjit. Zoti Pëllumbi e tha shumë qartë. Ky ligj nuk merr përsipër të rregullojë dhe të reformojë inspektimin. Reformimi i inspektimit ka filluar prej disa vjetësh në Shqipëri, është goxha sfidë, ka goxha përmirësim, u krijua inspektorati qendror. Përsëri ka sfida, kemi kaluar tek inspektimi elektronik, por nuk është kollaj i zbatueshëm gjithandej. Kemi problemin e disa inspektorateve që përplasen me një subjekt. Nuk janë të ndara shumë mirë linjat: fillimi dhe fundi i të drejtës së inspektimit. Kjo është një reformë më vete.

Shqetësimi që ngriti zoti zëvendësministër nuk mund të gjejë dot zgjidhje me këtë ligj. Ne nuk mund ta zgjidhim këtë konflikt në projektligj, por merret reformimi i të gjithë inspektimit me këto çështje. Në këtë ligj duhet të paktën të mos përjashtojmë inspektoratet që e kanë për kompetencë ligjore të inspektojnë ushqimin nga e drejta e tyre për të ushtruar detyrën. Nëse thuhet në mënyrë taksative : “Mostrat në doganë do t’i marrë Inspektorati i Shëndetit dhe Drejtoria e Doganave”, atëherë AKU-ja nuk ka të drejtë të marrë mostër dhe të bëjë analizat në laboratorët e saj, sepse e ke përcaktuar në mënyrë taksative, ndërkohë që për jodin deri dje AKU-ja e ka pasur të drejtën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj - Kemi treçerek ore që diskutojmë literalisht. “Inspektorat, që mbulon...”, ta zëvendësojmë me “Strukturë përgjegjëse që mbulon inspektimin”. Për këtë po diskutojmë.

Niko Peleshi - Ke shumë të drejtë që edhe sot është e paqartë, por ne po e marrim në dorë këtë ligj për të qartësuar disa gjëra.

Ilir Beqaj - Qeveria e ka sjellë këtë ligj për pamjaftueshmërinë e jodit te njeriu, jo për reformën e inspektimit dhe për reformimin e AKU-së. Ky është misioni që na ka ardhur ne. Po të jetë kështu, le t’ia kthejmë qeverisë mbrapsht dhe të na i sjellë të dyja bashkë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne nuk duam të bezdisim biznesin dhe ia shkruajmë këtu të dyja.

Robert Bitri – Ne duam të shtojmë kontrollin se deri më sot nuk e kemi bërë atë.

Ilir Beqaj- Jo, e kemi bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri - Ecëm shumë mirë në 5 -vjeçarin e parë, por sot nuk kemi ecur në mënyrë të tillë. 5-vjeçari i dytë tregon se kontrolli i kripës ose jodizimi i kripës nuk është bërë në cilësinë dhe në sasinë që ka hyrë. Prandaj duhet të vazhdojmë të shtojmë gjurmueshmërinë, kontrollin e mostrave, marrjen e tyre siç e kërkon ju për çdo ngarkesë. Këto janë masa. Ku është e keqja këtu, që do të shtojmë AKU-në edhe për kontroll? Le të vijë te laboratorit juaj, aty do të vijë t’i bëjë.

Kemi një orë që po mëremi me këtë gjë.

Niko Peleshi – Ta bëjmë pak më pragmatiste, çfarë ndryshon, nëse e shtojmë ushqimin?

Antoneta Njehrrrena - Kjo mund të sjellë që në këtë moment mund t’i shkojnë biznesit dy autoritete.

Niko Peleshi - Po sot sa i shkojnë?

Antoneta Njehrrrena - Këtë po e legalizojmë me ligj, po i themi: "...edhe për jodin...". Këtu do të krijohet konflikti, se AKU-ja do të shkojë...

Niko Peleshi – Zonja, le ta bëjmë një çikë më të thjeshtë.

Jam dakord. Në qoftë se ne themi: "dhe e ushqimit", do të shkojnë dy. Sot sa shkojnë? Shkojnë dy.

Antoneta Njehrrrena – Për jodin shkon vetëm një.

Niko Peleshi – Shkojnë dy, pra. kanë të drejtë të shkojnë dy.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Njehrrrena – Jo.

Niko Peleshi – Kanë të drejtë të shkojnë dy.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Njehrrrena – Edhe po ta shtojmë atë, nuk ndryshojmë asnjë gjë.

Niko Peleshi – Atëherë, juve nuk ju prish punë nëse shtohet dhe ushqimi.

Antoneta Njehrrrena – Por krijon më shumë problem, sepse sipas nesh, nuk mund të jenë bashkë shëndeti dhe ushqimi. Nuk mund të jenë.

Niko Peleshi – Po a janë sot dy?

Antoneta Njehrrrena – Shkojnë sepse ka një legjislacion të posaçëm për ushqimin. Ai shkon në bazë të ligjit të vet për ushqimin. Inspektori ynë, i cili do të shkojë për jodin, do të shkojë në bazë të këtij ligji.

Niko Peleshi – Çfarë ndryshon, në qoftë se ne themi: "edhe ushqimi"?

Antoneta Njehrrrena – Unë mendoj se krijon problem.

Niko Peleshi – Pse?

Antoneta Njehrrrena – Por do të shkojnë të dy bashkë...

Niko Peleshi – Po sot, a shkojnë të dy?

Antoneta Njehrrrena – Do të shkojnë të dy bashkë, në bazë të këtij ligji. Nuk mund të shkojnë të dy bashkë për të matur pamjaftueshmërinë jodike. Nëse tani shkojnë të dy bashkë, sipas legjislacionit të posaçëm, secili për të vetin, tani do të shkojnë të dy bashkë në bazë të këtij ligji. Kjo mund të krijojë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po çfarë ndryshon në praktikë, se nuk e kuptoj?

Antoneta Njehrrrena – Bie edhe qëllimi i ligjit. Qëllimi i ligjit është mbrojtja e shëndetit nga...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Pëllumbi, po kuadri ligjor është një, pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Njehrrrena – Nuk është çështje kompetence.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Kolegë, le të qartësohemi pak në ide, sepse duket sikur të gjithë kemi të drejtë. Në fakt, në thonjëza, edhe mund të kemi të gjithë të drejtë.

Tashti, janë dy ligje të ndryshëm nga njëri-tjetri. Pra, ligji “Për kontrollin e ushqimit”. Ky është ligji i inspektimit, që bën shëndeti, ligji “Për shëndetin”. Janë dy ligje të ndryshme nga njëri-tjetri.

A përfshihen dhe a përplasen bashkë elementë të caktuar të këtyre ligjeve? Nëse po, duhet ta ndreqin këtë. Besoj se po bëhen përpjekje për t’u ndrequr, duke bërë një fuzion të inspektorateve, por ligjet në vetvete janë të ndryshëm. Njëri ka të bëjë me shëndetin, tjetri ka të bëjë me ushqimin.

Unë nuk e di nëse nesër, kur të ndryshojmë ligjin për ushqimin, do të themi edhe për edhe shëndetin. Ky ligj sot është për shëndetin. Në qoftë se themi: edhe ushqimi, mendoj se hyjmë në kompetencat e një ligji tjetër. Nga ana tjetër, i jap të drejtë kryetarit, kur thotë: në praktikë na kanë lindur konflikte, na kanë lindur përplasje. Si do të na vijë ligji tjetër për ushqimin?

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Më falni, vetëm për të ndihmuar diskutimin.

Zoti Pëllumbi, ju keni të drejtën e arsytimit tuaj, por ky projektligj, në mos në këtë pikë, në ca pika të tjera i fuzionon të dy sektorët. Për shembull, aty ku thotë: “Lista e ushqimeve që përjashtohen nga detyrimi për të përdorur kripë të jodizuar del me udhëzim të përbashkët të ministrit të Bujqësisë dhe ministrit të Shëndetësisë.”.

Edhe ligji ekzistues thotë: “Ngarkohet ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit , që brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin rregulloren e përbashkët, në zbatim të pikave 1 dhe 2”.

Ky ligj i bashkon të dyja: edhe ushqimin, edhe shëndetin, e për mendimin tim me shumë të drejtë.

Zoti Roland.

Roland Kristo – Thjesht desha të thosha diçka: AKU-ja, në bazë të etiketës, shikon çfarë parametrash ka në mallin që do të përdoret për ushqim. Është kaq niveli i jodit, ka këto elementë, ka metale të rënda, prandaj dhe i bën të gjitha analizat. AKU-së i thuhet: mos u merr me jodin, sepse do të vijë dikush tjetër, që ta marrë këtë shishen dhe ta shohë nëse ka

apo s'ka jod. Ti merru me këto të tjerat. Ne lidhje me jodin që ka kjo këtu, do të merret një institucion tjetër.

Ideja qëndron këtu: merret mostra dhe i bëhen të gjitha analizat. I bëhen analizat, dhe del nëse i kalon apo s'i kalon parametrat sipas ligjit. Kaq është.

Tani, nëse do të fusim një, dy, tre apo tridhjetë inspektorate, dakord, si të doni ju.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zonjë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Njehrrrena – Hiqeni fare dhe jepjani AKU-së. Le t'ia japim komplet AKU-së. I gjithë argumenti në lidhje me përplasjen e inspektorateve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Le ta dëgjojmë pak zonjën!

Antoneta Njehrrrena – Atëherë, me pamjaftueshmërinë e jodit, që të mos përsërisim të njëjtat gjëra dhe të mos themi të njëjtat fjali, deri më tani është marrë vetëm shëndetësia, përfshi edhe strukturat rajonale të laboratorit, që dje quheshin Drejtoria e Shëndetit Publik.

Pra, këtë gjë e ratifikon tani edhe ky ligj. Në qoftë se do të ndjekim logjikën, sipas së cilës bezdiset subjekti, tashmë ne do ta bezdisim me ligj. Për veç shëndetësisë që e kemi në këtë ligj, të shtojmë edhe AKU-në. Kjo do të thotë që, në rast se ai do të bëjë dhjetë elementët, por do të bëjë edhe të njëmbëdhjetin, atëherë ky ligj le t'i kalojë komplet AKU-së.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Vetëm një pyetje. I erdhi AKU-së, e realizoi, doli me bakterie alkooli, çfarë bën AKU-ja? Çfarë kompetence ka?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, bakterie alkooli. S'ka lidhje me komponentët përbërës që kjo ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bakterie alkooli është ushqim apo shëndet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dhe e ka bërë. në rastin konkret ka bllokuar...

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Urdhëroni!

Arben Pëllumbi – Siç ju thashë edhe më parë, unë gjykoj se kemi të drejtë pothuajse të gjithë, por nuk po gjejmë dot zgjidhjen e gjësë, se cila është më e mira e kësaj pune. Atëherë, propozimi im është: zëvendësimi i fjalës inspektoriat me “strukturë përgjegjëse”. Pra, pa specifikuar as shëndet e as ushqim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Është evazive.

Eglantina Gjermani – Jo, jo, është shumë evazive.

Arben Pëllumbi – Po një strukturë përgjegjëse do të ketë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këtë ligj është strukturë përgjegjëse shëndeti, në atë ligj është ushqimi.

Eglantina Gjermani – Po ajo është shumë evazive dhe lë shteg për abuzime.

Arben Pëllumbi – Kush do të abuzojë?

Eglantina Gjermani – Do të shkojë dhe mjedisi pastaj. Përveç dyve, do të shkojnë tre.

Arben Pëllumbi – Ky ligj i jep në dorë strukturës përgjegjëse që kontrollon jodin. Strukturë përgjegjëse që kontrollon jodin sot është Inspektoriati i Shëndetit, nesër mund të jetë një inspektoriat tjetër. Pra, strukturë përgjegjëse. Përse duhet specifikuar deri në detaj: “për shëndetin” apo “për ushqimin”? Strukturë përgjegjëse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E lëmë të paspecifikuar, sepse e thotë ligji se çfarë mbulon. Ky është propozimi im.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zonja Gjermani. Më pas zoti Bici.

Eglantina Gjermani – Unë jam dakord që kjo gjë të ngelet kështu: struktura përgjegjëse që mbulon inspektimin në fushën e shëndetit. Unë besoj se projektligji është sjellë nga Ministria e Shëndetësisë. Po ta kishte marrë iniciativën Ministria e Bujqësisë, le ta sillte ndryshimin në projektligj. Besoj se AKU-ja ka një ligj të veçantë, ku mund të bëhen rregullime, reformime. Nuk besoj se ky është ligji i duhur për ta përfshirë AKU-në.

Niko Peleshi – Praktikisht, kjo është iniciativë e Ministrisë së Bujqësisë.

Eglantina Gjermani – Po themi ligjërisht, *de jure*, e ka sjellë Ministria e Shëndetësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po. Atëherë do ta respektojmë këtë gjë. Kur të vijë AKU-ja, mund t’ia përmirësojmë ligjin. Dakord jam. Më duket se po zgjatemi shumë me një nen të parë, i cili, pavarësisht se në praktikë mund të ketë probleme, mund të rregullohet me akte nënligjore, me praktika, me procedura, e jo domosdoshmërisht në ligj.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Të mos jetë përjashtues ligji. në qoftë se ligji është përjashtues, pra është taksativ...

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Meqenëse janë përplasur, le të vazhdojnë të përplasen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro, zoti Bici.

Dritan Bici – Këtu nuk është puna për përplasje. Këtu është puna për një element madhor, që Ministria e Shëndetësisë ka konstatuar se pamjaftueshmëria e jodit ka krijuar probleme shëndetësore te njerëzit. Ky është një problem që i takon shëndetësisë, jo AKU-së, sepse jodi nuk ushqen organizmin, por është një element që rregullon ekuilibrin e hormoneve te gjendurat tiroid, ndaj nuk mund të ketë AKU që ta kontrollojë këtë. Në qoftë se ju dini gjëra të tjera, të cilat ne s'i dimë, na i thoni, po për sa i përket këtij problemi që ka sjellë ministria e Shëndetësisë, është ajo struktura përgjegjëse, e cila mban përgjegjësi. Nuk mund të mbajë përgjegjësi Ministria e Bujqësisë apo ndonjë tjetër, sa i takon shëndetit të njerëzve. Ata kanë bërë studimin, ata e kanë konstatuar, ndaj ata duhet ta kontrollojnë. Nuk duhet ta kontrollojë as AKU-ja e as ndonjë tjetër. Sipas mendimit tim, ky është një problem madhor, nuk është një problem si me të gjitha ushqimet e tjera. Nuk është si gjithë ushqimet e tjera, sepse mungesa e proteinës nuk mund të shkaktojë në organizëm ato probleme që shkakton mungesa e jodit. Pamjaftueshmëria e proteinës bën që ushqimi të mos jetë shumë i shëndetshëm, por nuk e bën atë të dëmshëm.

Niko Peleshi – Si i bie tashti? Kush do ta kontrollojë proteinën? AKU-ja apo shëndeti?

Dritan Bici – AKU-ja, që e ka.

Niko Peleshi – Pse?

Dritan Bici – Sepse ajo është element ushqimor, ndërsa ky është element mjekues, kështu që s' mund ta ketë AKU-ja.

Niko Peleshi – Të dyja kanë lidhje me shëndetin publik, me shëndetin e njeriut: edhe proteina.

Zoti Pëllumbi. Më pas zoti Konomi.

Arben Pëllumbi – Këto ndryshime ligjore nuk vijnë ngaqë ne sot nuk kontrollojmë jodin në doganë. Ne e bëjmë këtë kontroll në doganë. Problemet që na kanë lindur në lidhje me mungesën e jodit në popullatë, nuk është se na kanë lindur ngaqë nuk kemi pasur ligj dhe kontroll. Ne po bëjmë ndryshime për të lejuar që në territorin e Republikës së Shqipërisë të futet edhe kripë e pajodizuar, për disa qëllime të caktuara. Sepse ka qenë taksative, që nuk lejohej hyrja e kripës së pajodizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam të saktë apo jo?

Kjo është e para. Sot, si në doganë, ose kryesisht në doganë, sepse me sa kuptuam nga diskutimet që bëmë, në prodhimin vendës nuk e kishim këtë lloj kontrolli. Në qoftë se na ka ardhur një mungesë e theksuar jodi në popullatë, ose që s'kemi arritur ato parametra që kemi synuar, nuk na ka ardhur nga importi, por na ka ardhur nga përdorimi i kripës vendëse, e cila në shumicën e rasteve është e pajodizuar.

Atëherë, ndryshimet që na kërkohen të bëjnë, lidhen me një kontroll më të shtuar në dogana. Ajo që ne propozuam është: po i njëjti kontroll i shtuar edhe në prodhimin vendës. Këtu i japim mundësi Ministrisë së Shëndetësisë, që të kontrollojë gjithë kripën që del në prodhim, por nga ana tjetër, me këtë ligj i japim mundësinë të bëjë edhe kontrollin e gjurmueshmërinë e jodit deri në momentin final, që është përdorimi nga konsumatori. Këto janë ndryshimet.

Kjo që po diskutojmë tashti ka të bëjë me një fakt. Pse na lind ky diskutim? Na lind sepse po diskutohet që, në kuadrin e reformimit të inspektorateve, për të mos shkuar tre, katër, pesë apo shtatë inspektoriate te dera e biznesit, duke e mërzhitur, për t'u bërë më modernë në rrugën tonë europiane, po bëhet një reformë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund ta marrim parasysh sot këtë reformë, që nesër të mos na vijë prapë ky ligj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ashtu vete sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë! Në doganë nuk ka një përfaqësues të Inspektoriatit të Shëndetësisë, të vendosur aty. Ka një përfaqësues të AKU-së. Kur AKU-ja shikon se është kripë e jodizuar, përveç punës se vet, i drejtohet dhe Inspektoriatit të Shëndetit për të kontrolluar jodin.

Pra, për mua mund të jetë në rregull edhe me 19 miligramë, por a është edhe për juve në rregull me 19? Para se ta lëshojë atë parti malli, pret edhe mendimin e inspektoriatit tjetër. Në këtë rast ka funksionuar kështu, por me sa po kuptojmë edhe nga kryetari, ky funksion nuk ka qenë gjithmonë pozitiv apo gjithmonë i konvergjuara ashtu siç duhet. Ka pasur edhe konflikte.

Prandaj, a mundemi ne ta ndreqim këtu, që nesër të mos e kemi më këtë konflikt, në rast se nuk do të kalojë ligji për bashkimin e këtyre inspektorateve? Se po kaloi, atëherë s'ka rëndësi fare, se po një do të jetë. Qoftë për shëndetin, qoftë për ushqimin, te jodi po një do të jetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Tani, edhe vetë fakti se ka një iniciativë për t'i bashkuar të dyja, tregon se pikat e përbashkëta janë të shumta. Për këtë arsye, sot për sot duhet t'i lëmë të dyja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dritan Bici – Të kontrollohen të gjitha: edhe kripa e vendit, edhe kripa që hyn. Kripa e jodizuar që hyn, mund të jetë më e kontrolluara, sepse hyn nga vendet e BE-së. Kështu që, ne s'po e ndajmë kontrollin. Kontrolli duhet të jetë edhe për brenda, edhe për krimin që jonizohet këtu, edhe për kripën që vjen prej andej.

Niko Peleshi – Ajo po, patjetër.

Tani, ju e keni parë se në të gjitha seancat e diskutimit të këtij projektligji kemi pasur Ministrinë e Bujqësisë dhe AKU-në. Pse ata janë prezentë këtu? Pse është Ministria e Bujqësisë në këtë projektligj? Nëse është kështu, atëherë le të vazhdojmë vetëm me shëndetësinë, dhe ata s'kanë punë fare. Pra, në qoftë se e shikojmë të ndarë me thikë.

Po krijuam këtë precedent, pastaj hapet një problem i madh në shumë të tjera. Për shembull, ja ku janë zonjat: proteina te buka. Si mendoni ju, kush duhet ta kontrollojë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po flas për proteinën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, të mos bëjmë diskutime kot. Unë nuk po them se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po kush e tha këtë? Po kush e tha se merret vetëm nga buka?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonjë, të lutem!

Nuk po diskutojmë se ku e merr proteinën. Po themi, ka një...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi një ligj, i cili ka fiksuar normën minimale të proteinës te mielli që përdoret për bukë. Sipas jush, kush do ta kontrollojë nivelin e proteinës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëri ligjet. Logjikisht, kush do ta kontrollojë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti e the mendimin rënd.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ktheji një përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Njehrrrena – Në tast se do të vazhdojmë me arsyetime, ka shumë tematika që e përplasnin realisht AKU-në me shëndetësinë. Rasti i kripës së joduar nuk është si ky rasti që sapo përmendët.

Niko Peleshi – Pse?

Antoneta Njehrrrena – Sepse studimet kanë vërtetuar se pamjaftueshmëria e jodit sjell ato probleme shëndetësore. Argumenti i bezdisjes së biznesit do ta shtonte, në rast se ne...

Niko Peleshi – Ne nuk po flasim fare për bezdisjen e biznesit.

Antoneta Njehrrrena – Ta mbaroj, të lutem!

Niko Peleshi – Por mos i ngatërro. Bezdisja e biznesit ka lidhje me një reformë tjetër, që është reforma e inspektimit. Nuk po flasim për këtë.

Antoneta Njehrrrena – Atë dua të them.

Niko Peleshi – Po flasim për fushën e përgjegjësisë. Ju lutem, përgjigjuni drejtpërsëdrejti...

Antoneta Njehrrrena – Drejtpërsëdrejti. AKU-ja nuk është marrë asnjëherë...

Niko Peleshi – Sipas jush, kush duhet ta kontrollojë proteinën? Lëre jodin. Po flasim për proteinën te buka. Kush duhet ta kontrollojë?

Antoneta Njehrrrena – Personi përgjegjës, sipas ligjit.

Niko Peleshi – Cili institucion, pra?

Antoneta Njehrrrena – Institucioni i AKU-së.

Niko Peleshi – I AKU-së?

Antoneta Njehrrrena – Po, s'është e barasvlershme me jodin.

Niko Peleshi – Po pse s'është e barasvlershme?

Antoneta Njehrrrena – Pikërisht për atë që sapo thashë: pamjaftueshmëria e jodit ka sjellë ato patologji mjekësore, për të cilat...

Niko Peleshi – Pse, pamjaftueshmëria e proteinës nuk shkakton patologji mjekësore? Është vendosur kot në ligj ajo normë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e sanksionojmë, se në projektligj keni të drejtë nuk është se ka qenë e zgjidhur deri tani. E ka zgjidhur praktika, e ka zgjidhur një ligj tjetër, i cili nuk ia kufizon veprimtarinë AKU-së, kur bie fjala te ushqimi. Pra, ku ka ushqim, AKU-ja hyn. Duke përdorur këtë ligj, kanë hyrë e janë përplasur edhe te jodi. Besoj se ky nuk ka qenë një diskutim i vetëdijshëm apo një përcaktim i vetëdijshëm në projektligj. Nuk besoj se është bërë një diskutim në

komisione e në seancë, si po e bëjmë ne sot. Sot, pas këtij diskutimi, në qoftë se ne pranojmë ta përjashtojmë AKU-në, pra autoritetin e ushqimit nga ky projektligj, e bëjmë me vetëdije, për t'i hapur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e përjashtojmë me këtë projektligj, pra. Ky është një ligj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, meqë ka qenë gabim, Ilir, nuk do të thotë të vazhdojmë ta lëmë ashtu. Në qoftë se kanë vepruar, duke gjykuar gjithmonë njëri-tjetrin, pse hyre në fushën time, pse të hyj në fushën tënde.

(Mungesë incizimi)

Po, sepse ka është atë nenin tjetër që thotë: “Në doganë merren mostra për çdo ngarkesë dhe analizat bëhen nga laboratorit i Institutit të Shëndetit dhe nga Drejtoria e Doganave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e përjashton laboratorin e AKU-së, se AKU-ja ka laboratorët e vet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk funksionojnë kështu. Në ligj, nuk e di nëse e vure re, përcaktohet në mënyrë eksplicite laboratorit ku duhet të bëhen mostrat, madje thuhet “laboratorit i vet”, pra përjashton edhe privatët, edhe institucionet e tjera. Kështu siç e kanë formuluar është përjashtues.

A ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar Ministria? Jo.

Roland, doje fjalën më duket!

A keni ndonjë propozim se si duhet të formulohet?

Roland Kristo – Pas fjalës “shëndetit” të thuhet “ose ushqimit” pa “dhe”, pastaj kjo delegohet dhe siguron frikën se do të shkojnë të dy, pra ose njëri ose tjetri. Kjo pastaj specifikohet me ligj të veçantë për punë të inspektimit. Në kuadrin e reformës një seri kompetencash të Inspektoratit të Shëndetësisë do t'i kalojnë AKU-së, me qëllim që subjekteve të mos u shkojnë 2, 3 apo 4 inspektorate, atje do të përcaktohet më saktë që këtë kompetencë e ka x institucion dhe këtë e ka y institucion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, është e gjithë pjesa tjetër e llojit të inspektimit që do të bëjë AKU-ja.

Niko Peleshi – Zoti Konomi.

Ardit Konomi – Zoti Pëllumbi i preku disa nga pikat që kisha, por po mundohem që gjatë gjithë kohës të përdor një logjikë të thjeshtë. Në fakt, AKU-ja është organi me nocionin ekzakt për të mbuluar kompetenca të tilla. Nuk jam për dublimin, as për ta lënë evazive në

ligj me “ose”, sepse do të krijojë gjithmonë problematika dhe do të rrisë tryshninë te bizneset dhe të gjitha ato efekte që njohim.

Unë mendova që ky mund të ishte një kontribut për reformën e inspektorateve. Të parashikohet që kompetenca t’i kalohet AKU-së dhe kjo e mbyll. Mua nuk më duhet ndonjë humbje e madhe për anën tjetër një tipar siç është kontrolli sasisë së jodit në produktet. Më mirë t’i kalojë kompetenca AKU-së se edhe kapacitetet janë, AKU-ia i ka degët e saj të shpërndara më mirë se çdo inspektorat tjetër në vend, pasi ajo është prezente në doganë e kudo dhe strukturën e ka më të ngritur.

Niko Peleshi – Po, zoti Bitri.

Robert Bitri – Prandaj unë them të ecim të tej.

Te neni 12 përcaktohet shumë qartë se kush e bën kontrollin dhe si, kështu që edhe nëse këtu do ta thuash “kontrolli i kripës së jodizuar, përshin veprimtarinë e mëposhtëm, monitorimin, i cili kryhet nga drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë, inspektimin, që kryhet nga inspektorati, i cili mbulon fushën e shëndetësisë”. Këtu mund ta shtojmë pjesën e ushqimit dhe nuk prish asgjë, sepse përcaktohet qartësisht si kryhet kjo.

Niko Peleshi – Edhe unë jam me zotin Bitri dhe do të propozoja që neni 1 të hiqet fare, pastaj aty ku bëhet fjalë për kontrollin, për shembull të neni 12, të diskutojmë nëse do të shtojmë edhe AKU-në apo jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pjesën e ministrisë ta lëmë dhe e shohim rast pas rasti, që të mos e bëjmë përgjithësuese.

Antoneta Njehrrëna – Në lidhje me atë që tha zëvendësministri, edhe sikur kjo kompetencë t’i kalojë AKU-së do të vazhdojë prapë të jetë pjesë e shëndetit, kështu që ajo do të jetë një strukturë që, në rast se do të kontrollojë kripën e jodizuar, do të jetë për shkak të shëndetit, pra për shkak të problemit që shkakton pamjaftueshmëria jodike. Pra, ka shumë kuptim që të jetë ashtu struktura përgjegjëse për shëndetin, edhe sikur të jetë nesër AKU.

Niko Peleshi – Keni shumë të drejtë, AKU-ja ekziston për shkak të shëndetit publik. Në shumë vende AKU-ja është pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë, sepse siguria ushqimore ka lidhje të drejtpërdrejtë me shëndetin publik dhe gjithë ky debat vjen pikërisht se ne shohim shumë pika të cilat përplasen me njëra-tjetrën, ndaj dhe debatojmë. Mirëpo, duke qenë se sot e kemi të pareformuar inspektimin, se e kemi në institucione të ndryshme, AKU-në e kemi te bujqësia, dhe unë jam që të qëndrojë te bujqësia për shumë arsye, por nuk është ky momenti për të diskutuar, na lind kjo problematikë. Neve na takon të bëjmë ligje jopërrjashtuese, prandaj po insistoje të jenë të hapura sot për sot dhe të mos kemi nevojë t’i ndryshojmë të

gjitha në një moment, kur të bëhet reformimi i inspektimit dhe disa kompetenca të shëndetit t'i kalojnë AKU-së dhe AKU-ja bëhet automatikisht autoriteti që i kontrollon, ndërkohë ti ke një ligj që e përjashton, kështu që do të të duhet ta ndryshosh ligjin përsëri.

Propozimi im është ta hedhim në votë dhe të heqim pjesën e dytë të nenit 1, të mos e përmendim fare zëvendësimin e inspektorateve me strukturat përgjegjëse për shëndetin. Duke lënë vetëm pjesën e parë të nenit 1 do të thotë ta lëmë siç e ka bërë KM-ja në të gjithë përmbajtjen e ligjit, pra emërtimi “ministri, Ministria i/e Shëndetësisë” zëvendësohet me “ministri, Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, varet si quhet.

Po.

Rolnad Kristo – Në kuadër të të gjithë këtij diskutimi që po bëjmë, ne nuk vëmë asnjëherë në dyshim që kontrolli i jodit, pavarësisht faktit nëse inspektoratet do të jenë veç apo bashkë, është tagër e strukturave të Ministrisë së Shëndetësisë. Shqetësimi që na lindi është që duke i dhënë këtë tagër në mënyrë specifike, mund të përjashtojmë AKU-në nga kontrolli që i takon të bëjë, qoftë dhe në kripë, pra jodin do ta ketë vazhdimisht nën kontroll Ministria e Shëndetësisë dhe jo shumë për momentin kur hyn se sa për gjurmueshmërinë e saj, se mund të jetë shumë i mirë kur hyn, por në momentin kur e merr ti, si konsumator, mund ta ketë jodin zero. Në këtë kuadër kontrolli, pa diskutim që duhet Ministria e Shëndetësisë, por, në pikën e parë, ku ky hyn mall në doganë apo del nga fabrika prodhuese, ne nuk mund t'ia heqim AKU-së të drejtën të kontrollojë parametra të tjerë, ndoshta duke përfshirë edhe jodin, por pak rëndësi ka, se kontrollin ndaj jodit e ka për detyrë ta bëjë kjo strukturë këtu. Kripa mund të ketë parametra të tjerë, si për shembull, metale të rënda brenda.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Diskutimi në këtë sens po bëhet, nuk është fjala kush do ta ketë kompetencën për jodin, se dihet që do ta ketë Ministria e Shëndetësisë, se nuk ka të bëjë me momentin e parë, por me gjurmueshmërinë e saj, por duke i dhënë këtë të drejtë Ministrisë së Shëndetësisë, të mos i heqim AKU-së të drejtën të kontrollojë atë që i takon asaj si ushqim.

(Mungesë incizimi)

Niko Peleshi – Po nuk është kështu more Tani, sepse si te proteina, ashtu dhe te jodi është e njëjta gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe në praktikë. Vendet që lejojnë përdorimin e kripës së pajodizuar nuk është se dëmtojnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë kalojmë në votim.

Kush është dakord me nenin 1, sipas variantit të KM-së?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 2.

Këtu nuk kemi propozim nga institucione të tjera.

Neni 2 thotë “Për nenin 3 termat “konsum direkt” dhe “konsum indirekt” zëvendësohen përkatësisht me “konsum i drejtpërdrejtë” dhe “konsum i tërthortë”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 3

As këtu nuk kemi propozim nga institucione të tjera.

Në nenin 6, thuhet në nenin 3, pas paragrafit të parë shtohen paragrafët si më poshtë:

“Lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar, vetëm me qëllimin e fortifikimit të kripës me jod nga subjektet e licencuara për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin. Lejohet përdorimi i kripës së pajodizuar në prodhimin e ushqimeve, përgatitja e të cilave parashikon domosdoshmërisht përdorimin e kripës së pajodizuar. Këto ushqime përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për Shëndetësinë dhe të ministrit përgjegjës për ushqimin. Lejohet eksporti i kripës së pajodizuar dhe i ushqimeve të prodhuara me kripë të pajodizuar në vende ku nuk ekziston ndalimi i përdorimit të kripës së pajodizuar”.

Për këtë nen kemi pasur diskutime sa i përket paragrafit të dytë dhe ndërkohë kemi propozuar që ky paragraf mund të zëvendësohet me një paragraf tjetër, i cili është disi më i ngushtë ose më i fokusuar. Pra, lejon përdorimin e kripës së pajodizuar vetëm për proceset e ndërmjetme, siç është regjja, domethënë kripa, e cila shpërllahet dhe nuk ngelet në produktin final. Vetëm në këto procese të lejohet të përdoret, si dhe në industrinë vendase, pra për tregun vendas.

Ndërkohë nuk e kemi mbështetur propozimin për të pasur një listë përjashtimore të përcaktuar me udhëzim të ministrave, por sot jemi këtu për ta votuar, kështu që po ia kaloj fjalën zotit Roland.

Urdhëroni!

Roland Kristo – Në germën “a”, nëse ngelet me variantin e propozuar këtu, lejohet importi i kripës së pajodizuar vetëm me qëllim fortifikimi, përjashton të gjithë pjesën e

industrisë që mund ta importojë kripën në regjim pezullimi doganor për të përdorur dhe riekportuar si pjesë e ushqimeve. Prandaj ndryshimi i bërë nga komisioni thotë “ Lejohet importi i kripës ushqimore vetëm për qëllim fortifikimi, si dhe me qëllim për prodhimin e ushqimeve të destinuara për eksport, sipas germës “b”. Pra shtohet pjesa që ai biznes ushqimor, i cili do ta përdorë kripën për të prodhuar ushqime me qëllim eksporti, do të ketë të drejtën ta importojë kripën. Ky është ndryshimi që u vendos në komision herën e kaluar.

Niko Peleshi - Një formulim nga Komisioni i Shëndetësisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E qartë, nuk e konsiderojmë dot, por mund ta lexojmë si formulim.

Po, urdhëro.

Ilir Beqaj – Te paragrafi i parë thuhet: “Lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar vetëm me qëllim fortifikimin e kripës me jod nga subjekte të licencuara për këtë qëllim”, licencimin e keni për atë që e sjell apo për atë që e fortifikon? Se ndoshta duhet parë nga ana gjuhësore, që të mos krijojë ambiguitet. Është çështje e presjes, pra duhet saktësuar.

Zëvendësministri ka të drejtë kur thotë se paragrafi i parë dhe i dytë janë pak kontradiktor me njëri-tjetrin. Mbase duhet të shkrihen në një, se ne i ndalojmë pastaj i lejojmë, ose do ta fillojmë me “përrjashtimisht”, se kështu siç është ne e lejojmë vetëm për qëllim fortifikimi, pastaj themi “po, lejohet edhe për prodhimin e ushqimeve”. Qëllimi juaj duhet rishkruar që të mos jenë kontradiktorë paragrafët.

Person f – Nga diskutimet që kemi pasur në Komisionin e Shëndetësisë kjo pjesë ka kaluar te neni 9, te ndalimet dhe është bërë si rast përjashtimor. Në fakt i gjithë neni është propozim i Ministrisë së Bujqësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj - ... autoritetet tona që x shtet e pranon të pajodizuar.

Pyetje konkrete. Ta zëmë se do të vij unë ta çoj diku. Nga informohet autoriteti që hap traun e eksportit, që në vendin x (nuk ka rëndësi vendi) kjo lejohet? Si bëhet kjo praktikë?

Arben Pëllumbi – Se këtu e kisha edhe unë.

Ilir Beqaj – Dakord, vazhdo. Më fal!

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Në vazhdim të kësaj që tha kolegu Beqaj, edhe unë kam dy gjëra. Ne e diskutuam edhe herën tjetër. Në pikën e parë, ku thuhet “vetëm me qëllim”, fjala “vetëm” duhet të hiqet, sepse është kufizuese.

Në qoftë se këto të dyja duam t’i bashkojmë bashkë, mund të themi: “Lejohet importi i kripës ushqimore të pajodizuar, me qëllim fortifikimin e kripës (pra, duke hequr fjalën

“vetëm”) dhe përdorimin e kripës së pajodizuar në prodhimet ushqimore”. Mund t’i lëmë edhe veç e veç, por fjalën “vetëm” duhet ta heqim.

Për sa i përket pikës së tretë, që nuk e kemi diskutuar, por e lamë ta diskutonim sot, kur të vinim nen për nen, mendoj se duhet ta heqim fare. Nuk është detyra jonë të shikojmë se ku shkon në eksport kjo kripë, sikurse nuk është detyrë e atij vendi atje të shohë nëse po vjen kripë e jodizuar apo e pajodizuar në Shqipëri, sepse Shqipëria ka kufizime me kripën e jodizuar apo të pajodizuar. Ai tjetri del në eksport dhe kjo është punë e tij. Është detyrë e vendit pritës të shikojë nëse ma lejon mua eksportin apo jo.

Për mua, pika e tretë duhet të hiqet fare. Nuk e kanë fare për detyrë institucionet tona se ku shkon kripa jonë në eksport, sepse mundet që edhe ai vendi pritës të ketë njëjtin legjislacion si ne dhe ta lejojë kripën e pajodizuar dhe pastaj ta jodizojë.

Tani, ne duhet të shikojmë që kudo shkon kripa jonë, a e lejon jodizimin, fortifikimin, proceset ndërmjetëse, po të njëjtën gjë që bëjmë ne?! Kështu që, për mua, pika e tretë, “lejohej eksporti i kripës”, nuk ka asnjë lloj...

Ne lejojmë eksportin e kripës. Të jodizuar apo të pajodizuar ky është problemi i vendit pritës, sikurse në këtë rast është problemi ynë a e lejojmë të futet në territor apo nuk e lejojmë.

Përse duhet të marrim ne përsipër çfarë bëjnë shtetet atje?

Niko Peleshi – E drejtë.

Nuk merremi ne me zbatimin e legjislacionit të shteteve të tjera.

Arben Pëllumbi – Sikurse kur ai e importon dhe e sjell këtu, a merret shteti i origjinës atje me “se shiko, legjislacioni në Shqipëri thotë kështu”? Nuk merret. Përse duhet të merremi ne me...? Ta heqim fare këtë pikë. E heqim edhe fjalën “vetëm” dhe kështu më duket se i kemi marrë parasysh të gjitha gjërat që kemi pasur ndër mend kur kemi diskutuar.

Në pikën e parë është: “Lejohej importimi i kripës ushqimore të pajodizuar vetëm me qëllim...”. Po the fjalën “vetëm”, i ke përjashtuar të gjitha të tjerat. Ndërkohë që më poshtë thuhet prapë “lejohej edhe për këtë”.

Të hiqet fjala “vetëm” dhe pika e tretë të eliminohet fare. Ç’na duhet ne?! Është puna e shtetit pritës pastaj nëse e lejon kripën tonë apo...

Eglantina Gjermani – Më fal, por aty thuhet “vetëm” për kripën ushqimore, pra vetëm ajo që përdoret për ushqim, vetëm po të jodizohet, jo se... Këtu bëhet fjalë për kripën ushqimore, ka dallim nga kripa tjetër.

Niko Peleshi –Ndërkohë, paragrafi i tretë thotë se lejohej edhe kripa për riekспорт.

Eglantina Gjermani – Nuk thotë “ushqimore”.

Niko Peleshi – Ushqimore janë të dyja.

Eglantina Gjermeni – Nuk thotë.

Niko Peleshi – Gabim!

Eglantina Gjermeni - E kemi kripë të pajodizuar emërtimin te dy të tjerat. Këtu e kemi ushqimore. Prandaj thotë “vetëm me qëllim...”

Niko Peleshi – A ka ndonjë arsye pse te paragrafi i parë përdoret “kripë ushqimore e pajodizuar” dhe te paragrafi i tretë thuhet thjesht “kripë e pajodizuar”?

Eglantina Gjermeni – Sepse do të përdoret për ushqim kjo. Prandaj thuhet “vetëm po të jodizohet”. Prandaj e ka përcaktuar kaq qartë.

Person f – Nuk ka ndonjë gjë, sepse thelbi i ligjit është i gjithi për kripën e jodizuar për qëllim ushqimor, pra mund të jetë thjeshtë...

Niko Peleshi – Atëherë, për të qenë korrektë edhe me paragrafin nr.1, duhet të jetë “kripa ushqimore e pajodizuar” edhe në paragrafin nr.3.

Arben Pëllumbi – Në paragrafin e parë flasim për kripë ushqimore dhe në paragrafin e dytë lejohet përdorimi i kripës së pajodizuar në prodhimin e ushqimeve. Po pse, kripë industriale do të kemi në prodhimin e ushqimeve?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eglantina Gjermeni – Po, por thotë se nuk e lejojnë kripën e pajodizuar.

Arben Pëllumbi – Mirë, por për prodhimin e ushqimeve. Të hiqet fjala “vetëm”.

Niko Peleshi - A kemi ndonjë propozim për paragrafin nr.2?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por për korrektesë sintaksore. Nuk ka rëndësi...

Çfarë mendimi keni për paragrafin nr.2 ? Kjo është thelbësore.

Ndërkohë, ju kujtoj se kemi dy amendamente. Zoti Baraj dhe zoti Pëllumbi kanë bërë amendamentet e tyre. Ndërkohë, kemi edhe propozimet e Ministrisë së Bujqësisë.

Ministria e Bujqësisë propozon që neni 3 të formulohet si më poshtë: “Pas germave “a” dhe “b”... Ku ka “a” dhe “b” këtu?

Roland Kristo – I ishim referuar variantit të paripunuar, pra u ripunua.

Niko Peleshi – ...të shtohet edhe paragrafi “Lejohet përdorimi i kripës së pajodizuar në prodhimin e ushqimeve, përgatitja e të cilave nuk parashikon domosdoshmërisht përdorimin e kripës së jodizuar. Këto ushqime përcaktohen sipas kriterëve si më poshtë:

1. produkte të destinuara për eksport;
2. produkte të peshkimit me origjinë nga deti;

3. produkte në të cilat kripa shërben si një ndër inputet e procesit teknologjik, me qëllim konservimin e ndërmjetëm, regjien, reaksionet kimike të procesit të përpunimit. Në këto raste produkti është i destinuar për përpunim të mëtejshëm. Përdorimi i kripës së pajodizuar lejohet vetëm mbi bazën e kartës teknologjike të miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Gjithashtu, në projektligjin që miratohet, nuk janë parashikuar ndryshimet në kundërvajtjet administrative, edhe pse në projektligj importi dhe përdorimi lejohen. Neni 17 e parashikon si shkelje administrative. Për këtë qëllim, pikat 1 dhe dy të nenit 17 duhet të riformulohen”. Ky është nen tjetër, ka lidhje me nenin 17.

Pra, me sa duket deri tani (do të duket me votë në fund), kemi një dakordësi që te paragrafi nr.1 të hiqet fjala “vetëm”.

Paragrafi nr.2 të zëvendësohet me një paragraf, që lejon përdorimin e kripës së pajodizuar për proceset e ndërmjetme.

Te paragrafi nr.3 të hiqet pjesa e fundit e fjalisë, ku thuhet “në vendet ku nuk ekziston ndalimi i përdorimit të kripës së pajodizuar”, pra të lihet vetëm “lejohet eksporti i kripës ushqimore të pajodizuar dhe i ushqimeve të prodhuara me kripë të pajodizuar”, pra eksporti.

Urdhëro, Xhilda!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, te paragrafi nr.2 thamë se do të përfshijmë proceset e ndërmjetme.

A keni ndonjë propozim tjetër?

Urdhëro!

Roland Kristo – Të mos harrojmë edhe pjesën e importit të kripës me qëllim prodhimin e produkteve që janë të destinuara për eksport.

Niko Peleshi – Po pra, është paragrafi i tretë.

Roland Kristo - Nuk u rilexua.

Niko Peleshi – E lexova.

(Diskutime pa mikrofon)

Te detajet ai ka futur eksportin, që ne e kemi te paragrafi nr.3, së dyti, produktet e peshkimit me origjinë nga deti... Ky nuk është proces kalimtar, por ushqim...

Për të thënë të vërtetën, kjo është kthim mbrapa, se sot për sot nuk lejojmë asnjë ushqim të pajodizuar, ndërsa në qoftë se përjashtojmë produktet me origjinë nga deti, për shembull, është një...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo e logjikshme, por është një ulje e shkallës së...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga një ndalim universal, bëhet një ndalim me përjashtime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro!

Roland Kristo – Thjesht për ta rikujtuar, se kjo pjesa e prodhimeve nga deti nuk u mor parasysh, kur ramë dakord, pavarësisht se mendimi im personal është që jodi vjen nga deti, prodhimet e peshkimit nga deti janë me nivel të lartë jodi. 100 gramë karkaleca...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, të mbaroj unë, pastaj...!

100 gramë karkaleca kanë dyfishin e normës ditore që i nevojitet njeriut.

Niko Peleshi – Sa karkaleca hanë njerëzit në ditë?

(Diskutime pa mikrofon)

Roland Kristo – Atëherë, kush do të hajë karkaleca me kripë, nuk ka nevojë ta përdorë kripën e jodizuar.

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull. Edhe unë dakord jam me atë, por ai që do të hajë karkaleca në kripë, nuk ka nevojë ta ketë kripën e jodizuar.

Niko Peleshi – Më fal, Roland, ju keni ndonjë insistim për këtë pjesë? Pra, kjo afekton gjithë sektorin apo është...?

Roland Kristo – Herën e kaluar u mbajtën parasysh vetëm për produktet për eksport dhe produktet...

Niko Peleshi – E kuptoj. A keni ju ndonjë insistim për këtë...?

Roland Kristo – Për mendimin tim është logjike (ne ia kemi dërguar dhe Ministrisë së Shëndetësisë në kohën kur e diskutonim) që një pjesë e madhe prodhimeve të peshkimit, të peshkut nga deti, ka një...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord.

Atëherë, kush është dakord me variantin e Këshillit të Ministrave të riformuluar (flasim për nenin 3)?

Do të mundohem ta formuloj, duke lexuar dhe duke kujtuar këto për të cilat kemi rënë dakord, pak a shumë. Shërbimet e komisionit do ta bëjnë këtë edhe teknikisht në raport.

Pra, neni 3 bëhet: “Në nenin 6, pas paragrafit të parë, shtohen paragrafët si më poshtë: “Lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar (e heqim fjalën “vetëm”) me qëllimin e fortifikimit të kripës me jod nga subjektet e licencuara për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin.””

Në vend të paragrafit të dytë, në variantin e Këshillit të Ministrave, vëmë këtë paragraf: “Lejohet përdorimi i kripës së pajodizuar, kur përdoret si një ndër inputet e procesit teknologjik, me qëllim konservimin e ndërmjetëm, regjien, reaksionet kimike të procesit të përpunimit. Në këto raste produkti është i destinuar për përpunim të mëtejshëm.” Pra, po adoptoj edhe propozimin nga Ministria e Bujqësisë.

Ndërkohë, paragrafi nr.3 bëhet: “Lejohet eksporti i kripës ushqimore (shtohet fjala “ushqimore”) të pajodizuar dhe i ushqimeve të prodhuara me kripë të pajodizuar”. Pra, heqim gjysmën tjetër të fjalisë. Me të drejtë, siç e tha edhe zoti Pëllumbi, nuk na takon neve të përcaktojmë vendet që e përdorin apo nuk e përdorin, apo të marrim parasysh...

Urdhëro, zoti Roland! Jemi në proces votimi. Vetëm në rast se ke ndonjë gjë...

Roland Kristo – Ma dhatë fjalën?

Niko Peleshi – Po, ta dhashë.

Roland Kristo – U harrua kjo: “...si dhe me qëllim prodhimin e ushqimeve të destinuara për eksport.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po pra, lejohet eksporti dhe i ushqimeve...

Roland Kristo – Nuk u lexua nga ju, pika 1 dhe pika 2.

Niko Peleshi – E lexova.

Roland Kristo – Po e ndiqja.

Niko Pelshi – “Lejohet eksporti i kripës ushqimore të pajodizuar dhe...”

Roland Kristo – Importi. Unë do të importoj kripë për ta përdorur më industrinë time ushqimore. Unë e importoj kripën me regjim dhe e nxjerr...

Niko Peleshi – Keni të drejtë.

Atëherë, te paragrafi nr.1 do të themi: “Lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar me qëllimin e fortifikimit të kripës me jod ose për qëllim...”

Ilir Beqaj – E kemi të dyshi atë.

Niko Peleshi – Te dyshi nuk është fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Importin, se ai thotë: “Ku ta gjej unë...”?

Ilir Beqaj – Kam përshtypjen, kryetar, nëse duam ta rregullojmë edhe këtë, është më mirë të mos e nxjerrim me “ose”, por me...

Niko Peleshi – Po, kështu e kemi diskutuar edhe një herë...

Ilir Beqaj – Pra, të zgjidhim një herë importimin për fortifikim, pastaj të zgjidhim importimin pa jod për teknologjinë ushqimore, pastaj përdorimin dhe më pas eksportin.

Propozoj t'i ndajmë në 4 momente, se do të jemi pak më...

Niko Peleshi – E drejtë.

Atëherë, neni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Mungesë regjistrimi)

Niko Peleshi – Lexojeni ju.

Ilir Beqaj – “Lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar, vetëm me qëllim...

Niko Peleshi – Hiqe fjalën “vetëm”.

Ilir Beqaj – Po, më fal! U hoq “vetëm”.

...fortifikimin e kripës me jod nga subjekte të licencuara për fortifikim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm me qëllim për fortifikim, për të qenë më...

(Deputeti Ilir Beqaj flet pa mikrofon.)

Niko Peleshi – Ndërkohë, për të mos e përsëritur atë që citoi zoti Beqaj, shtohet edhe një paragraf, ku thuhet: “Lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar, me qëllim përdorimin në produktet ushqimore të destinuara për eksport”.

Dakord.

Paragrafi nr.3: “Lejohet përdorimi i kripës së pajodizuar, si një ndër inputet e procesit teknologjik, me qëllim konservimin e ndërmjetëm, regjjen, reaksionet kimike të procesit të përpunimit. Në këto raste produkti është i destinuar për përpunim të mëtejshëm.”

Paragrafi nr.4: “Lejohet eksporti i kripës ushqimore të pajodizuar dhe i ushqimeve të prodhuara me kripë të pajodizuar”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E specifikuam.

Jemi dakord me këtë...?

Urdhëro!

Ilir Beqaj – Kush e arsyeton që kjo firmë po vjen për të prodhuar një gjë që lejohet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sipas kësaj, kam përshtypjen se ...

(Mungesë incizimi)

Niko Peleshi - ...paragrafin nr.3 për proceset e ndërmjetme apo kur përdoret për procese ...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E hoqëm atë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në paragrafin nr. 3 duhet të shtohet: “përdorimi i kripës së pajodizuar lejohet vetëm mbi bazën e kartës teknologjike të miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit”, siç e ka propozuar Ministria e Bujqësisë. Ndërkohë, shqetësimi që ngre zoti Beqaj ka lidhje me subjektin që importon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Roland.

Roland Kristo – Bëhet fjalë për mallra që do të riekportohen dhe që kanë hyrë me regjim. Për shembull, në kartën teknologjike thuhet që ky produkt përmban 10 gramë kripë për 100 mililitra ujë. Pra, është karta e miratuar nga AKU-ja. Kripa ka hyrë me destinacion për të prodhuar një mall të destinuar për eksport, i cili kontrollohet nga dogana. Ndryshe do të kishte evazion doganor. Pra, kripa do të hyjë siç hyn peshkun në industrinë fason.

Niko Peleshi – Dakord për eksportin për ato që janë me regjim të përkohshëm. Po kur përdoret për procese të ndërmjetme të produkteve ushqimore që do të shiten në tregun vendas?

Roland Kristo - Në pjesën e industrisë së ndërmjetme do të jetë karta teknologjike, e cila ...

Niko Peleshi – Dakord. Unë importoj kripë të pajodizuar dhe them që do ta mbaj në magazinë, sepse ka subjekte që e marrin për proces të ndërmjetëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë do ta mbaj në magazinë. Do të vij prodhuesi nesër ta marrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Kristo – Në këtë rast importuesi duhet të ketë kontratë me fabrikën e fortifikimit ose me fabrikën e ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë të kam përjashtuar nga ligji. Ti ke të drejtë ta importosh, por mbi bazën ose ta fortifikosh dhe për këtë duhet të më japësh kontratën që ke lidhur me firmën fortifikuese, ose ta përdorësh industrinë ushqimore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord, sepse bëjmë gjithmonë të njëjtin gabim.

Dakord për importin, kurse ai që e prodhon në vend do ta mbaj në magazinë. E kam prodhuar dhe e kam të pajodizuar, thotë, sepse pres të ma blejë ndonjë tjetër për proces të ndërmjetëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për blegtorinë duhet e jodizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me ligj, po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti pëllumbi ka kërkuar fjalën për të bërë një sqarim.

Arben Pëllumbi – Në momentin që kemi hequr fjalën “vetëm”, ne kemi lejuar të importohet kripa, pavarësisht subjektit dhe themi për cilat arsye lejohet të importohet. Për ta fortifikuar, por jo detyrimisht fortifikuesi importon kripën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të mos jetë. Fortifikuesi je ti, importuesi jam unë.

Ilir Beqaj – Unë bëj vetëm fortifikimin.

Arben Pëllumbi – Si e zgjidhim te pika e parë. Ti bën fortifikim, unë bëj importim kripe. Unë të them që mua do të më lejosh ta bëj importimin e kripës, sepse unë kripën e shes për efekte fortifikimi. Unë vetë nuk kam fortifikim, por do t’ia jap Ilirit apo tjetrit. Ky problem na lind në të gjithë këtë nen të ligjit. Si do ta lejojmë futjen në doganë apo daljen nga fabrika e prodhimit, që është e njëjta gjë? Kur të vijë kontrolli përkatës për të kontrolluar jodin dhe të të pyesë pse e ke pa jod, zotëri, unë mund t’i them që e kam pa jod, sepse unë kam kontratë me kolegun për t’ia shitur për fortifikim. Nuk e zgjidhim ne në ligj këtë gjë.

Niko Peleshi – Zonja Gjermani më tha diçka dhe ka të drejtë. Nuk zgjidhen dot të gjitha në ligj, prandaj të dalë një akt nënligjor për ta zgjidhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, Roland.

Roland Kristo –Për sa i përket udhëzimit, ju e mbani mend, kur u bë takimi me grupet e interesit këtu, ata e kundërshtuan në mënyrë thelbësore çështjen e udhëzimit vetëm me faktin që do të trokisnin në dyert e ministrive për të futur produktin në listë dhe kjo do të varej nga Ministria e Bujqësisë dhe ajo e Shëndetësisë. Ky është shqetësimi që u ngrit nga dy përfaqësuesit e shoqatave në mbledhjen e fundit. Prandaj, u vendos që ta specifikojmë qartësisht me kategori të qarta në ligj që të mos ketë mundësi abuzimi dhe të jenë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë po rikujtoj diskutimin që u bë në atë kohë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jolanda Hyska – Personalisht kam dëshirë ta heqim fjalinë “përcaktohen me udhëzim të”, duke pasur edhe idenë që në sa më pak dyer të trokasësh, aq më mirë është. Nga ana tjetër, ne nuk mund t’i heqim të drejtën e bërjes së tregtisë dikujt, i cili nuk bën as

fortifikim dhe as procese ndërmjetëse. Ndryshe e kufizojmë që importin e kësaj kripe të pajodizuar duhet ta bëjnë vetëm ata që e përdorin.

Ilir Beqaj – E keqja është që duke ia lënë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jolanda Hyska Ideja është ta bllokojmë që askush të mos importojë kripë të pajodizuar nëse nuk e përdor për vete. Mund ta bëjmë edhe këtë, sepse çështjen e shëndetin e kemi më të rëndësishme sesa çështjen e një tregtari.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu poshtë e lejojmë edhe për një qëllim tjetër, përveç fortifikimit. Fjala “vetëm, bëhesh përjashtuese.

Eglantina Gjermani – Nëse përdoret për ushqim duhet patjetër të jetë e fortifikuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Kështu siç është formuluar i bie ta importojnë vetëm subjektet që e përdorin. E lëmë kështu.

Kush është dakord me formulimin e ri mbi variantin e Këshillit të Ministrave me katër paragrafë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet sipas variantit të Këshillit të Ministrave me ndryshimet e theksuara që do të formulohen nga shërbimet e komisionit në raportin përfundimtar.

Neni 4.

Ky nen merret me nenin 12 të ligjit. Neni 12, thotë neni 4, riformulohet si më poshtë, vijon.

“Neni 12.

Kontrolli i kripës së jodizuar.

1 – Kripa e jodizuar, e prodhuar ose importuar, e destinuar të tregtohet në Republikën e Shqipërisë është objekt kontrolli. (Këtu kemi edhe riformulim nga Ministria e Shëndetësisë).

2 – Kontrolli i kripës së jodizuar përfshin veprimtaritë e mëposhtme:

a) monitorimin, i cili kryhet nga drejtoritë rajonale vendore të shëndetësisë.
b) inspektimin, i cili kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë.
c) ministri përgjegjës për Shëndetësinë, për përcaktimin e nivelit të jodit në kripën e jodizuar përcakton institucionet shëndetësore që do të kryejnë analizat.

ç) kontrolli i kripës së jodizuar për përcaktimin e nivelit të jodit në mostrën e kripës së jodizuar bëhet nëpërmjet analizave laboratorike në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe

sipas rekomandimeve të OBSH-së, ICCIDD-së dhe UNICEF-it”. Ky është varianti i Këshillit të Ministrave.

Varianti i propozuar nga ministria është:

“Neni 12.

Kontrolli i kripës së jodizuar.

1 – Kontrolli i kripës së jodizuar, e prodhuar ose e importuar, e destinuar të tregtohet në Republikën e Shqipërisë, bëhet nëpërmjet analizave laboratorike në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas rekomandimeve të OBSH-së, ICCIDD-it dhe UNICEF-it.

2 - Kontrolli i kripës së jodizuar në subjektet prodhuese të kripës së jodizuar bëhet për çdo parti malli para hedhjes së saj në treg nga struktura rajonale e shëndetësisë. Për kryerjen e analizave të kripës struktura rajonale përdor laboratorët e brendshëm të saj.

3 – Kripa e jodizuar që importohet në Republikën e Shqipërisë nga subjektet importuese i nënshtrohet në kontrollit në pikat doganore (degët doganore kufitare). Ky kontroll realizohet nga autoriteti doganor dhe drejtoritë rajonale të shëndetësisë. Për kripën e jodizuar të importit edhe në rastet kur në dokumentet shoqëruese është pasqyruar niveli i jodit, importuesi është detyruar të kryejë analizat laboratorike në laboratorët e strukturës rajonale të shëndetësisë për nivelin e jodit në çastin e futjes së kripës në pikën doganore.

4 – Shpenzimet për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave laboratorike të nevojshme për kontrollin e kripës së jodizuar përballohen nga subjektet prodhuese ose importuese të kripës së jodizuar. Tarifat përcaktohen me VKM.

5 – Inspektimi për kripën e jodizuar kryhet nga struktura përgjegjëse për inspektimin shëndetësor në bazë të planifikimit sipas vlerësimit të riskut, raporteve të monitorimit dhe strukturat rajonale dhe/ose vendore të shëndetësisë dhe nga sinjalizimet nga burimet e tjera”. Çfarë do të thotë “nga sinjalizimet”?

Ky është neni që lidhet me debatin që bëme në fillim të diskutimit. Është shumë e qartë që këtu fiksohet vetëm shëndetësia për inspektim, monitorim dhe kontroll.

Ilir Beqaj – Kryetar, për të qenë më produktiv, mbi cilin nga versionet do të diskutojmë?

Niko Peleshi – Ne do të diskutojmë mbi versionin e Këshillit të Ministrave, për të cilin kemi një input nga Ministria e Shëndetësisë. Kemi ndonjë propozim nga amendamentet? Asnjë nga amendamentet nuk ka lidhje me nenin 12?

Po, zoti pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Ne vërtet kemi variantin e Këshillit të Ministrave, por nga diskutimet që kemi bërë këtu, ndryshimet që ka bërë Ministria e Shëndetësisë përfshijnë një

pjesë të shqetësimeve që kemi pasur edhe ne. Më kryesori është kontrolli i kripës së jodizuar nga subjektet prodhuese të kripës. Pra, ligji nuk e lë vetëm në kuadrin e importit, por përfshin edhe subjektet prodhuese të kripës. Pra, i vë në të njëjtin nivel edhe prodhuesit vendas, edhe eksportuesit në lidhje me jodizimin e kripës dhe kontrollin e saj.

Niko Peleshi – Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Kur flasim për struktura, unë besoj se duhet t'i referohemi variantit të propozuar nga ministria, jam dakord me zotin Pëllumbi. Te varianti i ministrisë, te pika 3 thuhet: “Ky kontroll realizohet nga autoriteti doganor, drejtoritë rajonale të shëndetësisë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Niko Peleshi – Po.

Ilir Beqaj – Duke ngelur te versioni i fundit që na propozohet në pikën 2, në fjalinë e fundit thuhet: “Për kryerjen e analizës së kripës struktura rajonale përdor laboratorët e brendshëm të saj...”, unë nuk jam dakord me këtë formulim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pika 2, fjalia e fundit. Unë sugjeroj të qëndrojmë te formulimi paraparak, pra është ministri përgjegjës që përcakton institucionet se ku do të bëhen analizat. Po marr një gjë të thjeshtë, ndodh rëndomtë që një pajisje dëmtohet ose ka defekt për 2-3 ditë, nganjëherë edhe për 6 muaj dhe nga ky defekt të gjithë ngrijnë. E para.

E dyta, laboratorët janë instrumente mbështetëse, sot mund të jenë të brendshëm, nesër mund të jenë të jashtëm, pasnesër mund të jenë me partneritet, ndërsa ministri e ka autoritetin të thotë që analizat për kripën e jodizuar do të bëhen në këta laboratorë që unë njoh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di ministri, sepse ka një rregull. Ne ministrave u japim shumë më tepër përgjegjësi sesa kaq, prandaj kemi besim tek ata. Pra, nuk është nevoja të themi: laboratorët e brendshëm të strukturave.

Te pika 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo kryerjen e analizave, ashtu siç këtu: “Ministri përcakton institucionet ku kryhen analizat”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po kush?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku bëhen analizat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë duhet ta themi. Pastaj analizën kush e bën? Në këtë rast analizën e bën struktura shëndetësore, nuk e bën privati. Strukturat shëndetësore e bëjnë analizën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, ministri i thotë strukturës së vet që analizat do të bëhen në këta laboratorë, nuk mund të jetë kaq e liberalizuar.

Niko Peleshi – Ne prandaj e kemi akreditimin, pra nëse akreditoresh, do të thotë që ke të drejtë të punosh në treg.

Ilir Beqaj – Po ta shkruajmë këtu “në laboratorët e akredituar”, atëherë do të na duhen disa vite sa të kemi laboratorë të akredituar në të gjithë territorin e Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e cakton ministri listën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, dakord, më dëgjo një sekondë, ashtu siç është e shkruar këtu, në një moment që ka defekt laboratorit i Gjirokastrës, brenda shëndetësisë Gjirokastra nuk e çon dot te homologu në Korçë, sepse nuk e lejon këtë. Duke e shkruar që ministria e bën listën e laboratorëve që njeh, mbaron punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Laboratorët duhet të ishin të akredituar, pra kjo duhet të kishte ndodhur dje. Përse ne jemi vonë, kjo është një çështje që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, ministri të caktojë laboratorët se ku do të bëhen analizat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

T’i them një herë të gjitha komentet që kam. Në pikën 3, pjesa e fundit e fjalisë së fundit, ku flitet për nivelin e jodit të kripës, në çastin e futjes në pikën doganore, unë mendoj që është e panevojshme, sepse e kemi thënë më lart që kontrollin e bën dogana, pra dogana do ta bëjë aty kontrollin, nuk e bën në shtëpi. Pra, është përsëritje e asaj që kemi thënë më lart, sepse i gjithë ky ligj jodin kontrollon.

Te pika 5 thuhet: “Inspektimi për kripën e jodizuar kryhet nga struktura përgjegjëse për inspektimin shëndetësor në bazë të planifikimit sipas vlerësimit të riskut”, vlerësimi i riskut nuk planifikohet. Nëse ti vlerëson riskun, shkon...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, vendosim presje “Sipas vlerësimit të riskut, sipas raportit të monitorimit...”, atëherë do ta vendosim fjalën “sipas” gjithmonë që të ketë kuptim, “Sipas raporteve të monitorimit nga strukturat rajonale ose vendore të shëndetësisë...” këtë të mos e shkruajmë, sepse e kemi thënë në fillim që monitorimin këta e bëjnë. Pra, në bazë të ligjit, ata e bëjnë monitorimin, sepse e kanë kompetencën edhe nga sinjalizimet e burimeve të tjera. Ne përdorim 5 herë fjalën “sipas” që të ketë kuptim dhe homogjenitet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, e vendosim fjalën “sipas” pastaj “a”, “b”, “c” ose me dy pika, si të doni.

Zoti kryetar, këto ishin sugjerimet e mia për këtë version të formulimit.

Niko Peleshi – Ndërkohë, kemi amendamentin e zoti Baraj. Në pikën 4 thuhet: “Shpenzimet për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave përballohen nga subjektet prodhuese”. Zoti Baraj propozon që kjo tarifë t’u hiqet subjekteve dhe të paguhet nga institucionet e shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Unë kam dy gjëra. E para, kam përshtypjen se na ka shpëtuar diçka. Në variantin e Këshillit të Ministrave, në pikën 3 flitet për faktin që ministri përgjegjës për shëndetësinë përcakton nivelin e jodit në kripën e jodizuar, këtë nuk e shikoj në variantin e Ministrisë së Shëndetësisë se kush e përcakton nivelin e jodit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Cila pikë ishte kjo, Beni?

Arben Pëllumbi – Në pikën 3, varianti i Këshillit të Ministrave

Niko Peleshi – Në nenin 3?

Arben Pëllumbi – Jo, këtu ku jemi në pikën 3 të nenit 12. “Ministri përgjegjës për shëndetësinë bën përcaktimin e nivelit të jodit në kripën e jodizuar”, pra në këtë variant përcaktohet niveli i kripës së jodizuar, të cilën e bën ministri, ndërsa në variantin e Shëndetësisë nuk e shikoj të flitet për nivelin e jodit.

Niko Peleshi – A ka një arsye përse është hequr?

Ilir Beqaj – Kam përshtypjen që fjala “përcaktim” nuk ka pasur kuptimin për standardin, por ka për matjen konkrete, pra fjalia fjalën “përcaktim” e ka pasur për mostrën konkrete, nuk e ka pasur për nivelin e vënë atje...

Arben Pëllumbi – Po nivelet janë me udhëzim?

Ilir Beqaj – Po, janë në një nen tjetër. Pra kjo fjali bën fjalë për matje konkrete.

Arben Pëllumbi – E dyta, në lidhje me amendamentin që ka bërë kolegu Baraj, për shpenzimin e kësaj pune, ne duhet të jemi të qartë që ky është një problem kombëtar, që do të

thotë që ne si qeveri kemi një shqetësim, që është mungesa e jodit në popullatë. Përse duhet që një pjesë të këtij shqetësimi t'ia faturojmë privatit, që të paguajë analizat? Ky ka qenë edhe shqetësimi i zotit Baraj, nëse duhet ta hapim si diskutim. Shpenzimi është aq i vogël sa që ndoshta nuk ia vlen as që të flasim për këtë gjë, por duhet parë në koncept. Pra një shqetësim kombëtar nuk kemi përse t'ia ngarkojmë privatit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë le t'ia mbajë shteti atë 300 lekëshin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është çështje koncepti, nuk është çështje shpenzimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Unë mendoj se sido që ta shkruajmë ne, në fund fare kjo do të jetë pjesë e koston dhe e çmimit të shitjes. Nëse këtë tarifë do t'ia vendosim biznesit, ai do ta reflektojë te kostoja; nëse do ta paguajë shteti, atëherë ai do të duhet të rrisë disa taksa më shumë që të përballojë këtë kosto, në fund të fundit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – E gjithë kripa në det do të shkojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është çështje koncepti, sepse në përgjithësi shteti përpiqet që hallet e veta t'i zgjidhë nëpërmjet operatorëve privatë. Pra, kjo është çështje koncepti.

Ilir Beqaj – Ky është halli i shoqërisë, nuk është i shtetit.

Arben Pëllumbi – Dakord, por interesat e shoqërisë shteti i mbron.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Fjalën e ka zëvendësministri. Ju lutem, diskutoni edhe për çështje se cili institucion do ta ketë drejtën për kontrollin e monitorimit, pra atë që diskutuam në fillim, se si mund të riformulohet.

Roland Kristo – Me sa mbaj mend, shqetësimi i zotit Baraj nuk qëndronte te kostoja, por te diskriminimi që i bëhej kripës së importit me atë të vendit. Në këtë rast ngriti edhe problemin e OBT-së. Pra, nëse kripa që vjen nga importi tarifohet qoftë edhe me 2 lekë, atëherë je në shkelje të OBT-së. Ky është shqetësimi kryesor. Nëse parashikohet që tarifa prej 300 lekësh do të jetë edhe për prodhimin vendas në pjesën e kontrollit, por unë nuk besoj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra. Ky ka qenë shqetësimi i zotit Baraj, me sa mbaj mend, në diskutimet që janë bërë këtu.

Niko Peleshi – Të bëjmë një riformulim për çështjen e inspektimit të kontrollit, cilaq do të jetë struktura përkatëse?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu e thotë, por ne diskutuam që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne e hoqëm, nuk e votuam.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kemi formulim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Përfaqësuesi i AKU-së, nuk keni ndonjë formulim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ashtu siç ka qenë në ligj. Sipas jush AKU-ja nuk duhet të ketë të drejtë të kontrollojë jodin në kripë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ledio Lollari – Po, zoti kryetar, ashtu mendoj.

Niko Peleshi – Pra, AKU nuk ka të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përfaqësuesi i AKU-së, ju keni ardhur kot këtu? Përse keni ardhur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse ti nuk ke asnjë propozim për këtë pjesë, pra nëse pranon që ky është ligji i shëndetësisë, zbatohet nga strukturat e shëndetësisë, është kompetencë e tyre e të tjera, ti çfarë do këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për çfarë ke ardhur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

T'i kishim ndarë punët, dikush të ishte kërkuesi, ndërsa tjetri oportunisti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, se na ke zënë vendin kot, aty duhej të ishte ulur zëvendësministri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë lidhje ke këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është presion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dua të di cili është interesi i AKU-së për këtë projektligj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, urdhëro.

Ledio Lollari – Në cilësinë e përfaqësuesit të AKU-së, siç e tha edhe zëvendësministri, ne faktikisht i kryejmë të gjitha kontrollet e mundshme referuar kripës si produkt ushqimor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne i kryejmë *de jure* dhe *de facto*...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të dyja bashkë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, zoti kryetar, kompetencat u ezauruan pak më parë dhe u lanë për inspektoriatin shëndetësor dhe atë të ushqimit.

Niko Peleshi – Jo, nuk e ke pasur vëmendjen. Ne thjesht e hoqëm dhe thamë që nuk do ta përcaktojmë në mënyrë gjeneraliste një herë e mirë te neni 1, por e hoqëm fare nga neni 1 dhe, kur të shkojmë te inspektimi, monitorimi dhe kontrolli nen për nen dhe pikë pas pike, aty do të diskutojmë nëse do të jetë vetëm shëndetësia apo do të jetë edhe... Prandaj na thuaj mendimin tuaj.

Ledio Lollari – Unë i ngelem variantit për mbajtjen e kompetencave për këtë problem.

Niko Peleshi – Vetëm nga AKU-ja.

Ledio Lollari – Po, vetëm nga AKU-ja.

Niko Peleshi – Ilir, përfaqësuesi i AKU-së thotë që të gjithë kompetencën ta ketë vetëm AKU-ja dhe jo AKU-ja e të tjerë. Thjesht për ta ditur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po them që ka të drejtë.

Ilir Beqaj – Nga eksperiencia ime modeste si deputet opozite, maxhorance dhe si ish-ministër mendoj që çdo institucion përgjegjës qeveritar ka pasur mundësi në Këshillin e Ministrave të shprehë kërkesat e veta dhe Këshilli i Ministrave e ka marrë apo jo parasysht dhe ka ardhur ky projekt këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Kjo është e vërtetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Realisht ka të drejtë, sepse ministri i Bujqësisë apo i Shëndetësisë ka qenë në mbledhje të Këshillit të Ministrave dhe këto propozime nuk duhet të vinin këtu, sepse po

bëjmë ne punën e qeverisë. Roland, këto propozime a janë bërë në Këshillin e Ministrave dhe nuk janë marrë parasysh dhe ju po loboni këtu apo çfarë?

Roland Kristo – Ne duhet të kemi parasysh këtë faktin e ristrukturimit të dy institucioneve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të bëhet në mbledhjen e ardhshme të qeverisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rast se do të miratohet, atëherë të mos e riamendojmë edhe një herë këtë ligj. Nëse doni, mbani këtë pozicion, në muajin janar kur të futet në fuqi do të riamendohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka një vullnet të qeverisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Jo, se nuk kishte folur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përfaqësuesi i AKU-së dhe zëvendësministri po kërkojnë që AKU-ja të mos përjashtohet nga e drejta për të kontrolluar, kjo me shumë të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne po bëjmë një precedent, prandaj nuk po insistoј kot, me ligj AKU-ja nuk mund të përjashtohet nga asnjë lloј ushqimi apo përbërësi ushqimor, pra nuk mund të përjashtohet nga e drejta e kontrollit, monitorimit dhe inspektimit. Ju mund ta monitoroni jodin sipas procedurave dhe protokolleve tuaja, si ka shkuar deficienca në popullatë e të tjera, kjo është në rregull. Po të doni dhe po të bini dakord, mund të bëni kontrollin tuaj edhe për çdo mostër në doganë, në qoftë se e gjykoni që ju si shëndetësi se është kritike, por nuk mund ta përjashtoni AKU-në nga e drejta e inspektimit dhe e kontrollit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonjë, ligji është përjashtues dhe thotë: “Inspektimi për kripën e jodizuar kryhet nga struktura përgjegjëse për inspektimin shëndetësor”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por nuk ekziston kripë tjetër ushqimore, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kripa ushqimore është vetëm e jodizuar, sipas këtij ligji.

Ilir Beqaj – Unë sugjeroј që këtu të jenë të dy ministrat, sepse vetëm ata mund ta ndajnë këtë punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të vijnë dy ministrat të na thonë si e duan dhe ne të ngremë dorën si në teatrin e kukullave që i mbajnë me spango.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Pendavinji – Mua nuk më ndalon dot që të flas çfarë të dua.

Niko Peleshi – Kemi një deputet që është anëtar i dy komisioneve dhe është si pika e lidhjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Pendavinji – Mendoj që rekomandimet të kalojnë siç do t'i nxjerrë ky komision dhe më pas në komisionin përgjegjës, që është Komisioni i Shëndetësisë, të vijnë dhe të përgjigjen të dy ministrat, ose t'u kërkojmë një mendim atyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – A ka ndonjë propozim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për propozimin e fundit po thua?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e bëjmë praktikisht, por kështu ia kufizojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duke thënë “inspektoratit apo strukturat përgjegjëse të shëndetit”, ju lëmë në kompetencë të kontrollojnë vetëm nivelin e jodit, ua kufizojmë kontrollin. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Duke folur për kripën në përgjithësi të jonizuar, ekziston rreziku që të përjashtohet AKU-ja. Ndërsa, duke i dhënë të drejtën vetëm për nivelin e jodit në kripë, këtë kontrollon Inspektorati i Shëndetit Publik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo tjetra vazhdon të bëjë punën e saj, por për jodin janë këta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kripa e jodizuar është një element më i gjerë, ndërsa jodi në kripë ngushtohet që ka të bëjë me shëndetin e popullsisë.

Niko Peleshi – Ka shumë të drejtë, sepse, po the që inspektimin për kripën e jonizuar e kryen struktura përgjegjëse për inspektimin shëndetësor, e ke përjashtuar AKU-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, të bëjmë një përmbledhje duke i integruar të gjitha propozimet. Në qoftë se kalojnë si paketë shumë mirë, përndryshe i marrim një për një propozimet. Më thelbësorja është se në nenin 12 kur bëhet fjalë për kontrollin, monitorimin dhe inspektimin, në të gjitha

rastet fjalët “kripën e jonizuar” t’i zëvendësojmë “me nivelin e jodit në kripë”. Pra, kontrolli i nivelit të jodit në kripë përfshin veprimtaritë e mëposhtme:

- a) monitorimin, i cili kryet nga drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë,
 - b) inspektimin, i cili kryet nga inspektorati, i cili mbulon fushën e shëndetësisë,
- por kemi thënë që bëhet fjalë për nivelin e jodit në kripë. Nesër AKU-së, në qoftë se kontrollon kripën, nuk i thua dot çfarë ke ti me kripën e jonizuar. AQKU-ja thotë: është kjo kripë e jonizuar?

Ilir Beqaj – Është kripë ushqimore?

Niko Peleshi – Është kripë ushqimore, është jodizuar? Atëherë, lejohet. Në qoftë se nuk është e jonizuar, nuk lejohet. Ndërkohë që ju, si Inspektorat i Shëndetësisë, shkoni dhe thoni se kjo është kripë e jodizuar. Etiketa thotë që është e jonizuar. Mbaruat punë me AKU-në, sepse AKU-ja shikon etiketën ose bën kontrollin në laboratorët e saj, por për sa i përket nivelit të jodit, merremi ne. Tani Rolandi mund të thotë se do të bezdiset biznes. Por ne nuk e marrim do të përsipër të reformojmë të gjithë inspektimin me këtë projektligj. Kur të reformoni inspektimin, atëherë shkrijini të dyja. Pra, propozimi i parë është që “kripa e jonizuar” të zëvendësohet me “nivel i jodit në kripë”.

Po punojmë mbi formulimin e Ministrisë së Shëndetësisë. Te pika 1 nuk ka propozim për ndryshim. Te pika 2 kemi fjalinë e fundit që thotë: “Për kryerjen e analizave të kripës struktura rajonale përdor laboratorët e brendshëm të saj”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, po e lëmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mos hapet për privatët, është ideja. Në rregull, e lëmë kështu siç është. Pra, edhe këtu nuk ka ndryshim.

Pika 3: ‘Kripa e jonizuar që importohet i nënshtrohet kontrollit në pikat doganore, në degët doganore. Ky kontroll realizohet nga autoriteti doganor, drejtoritë rajonale të shëndetësisë’. Edhe këtu duhet bërë “nivel i jodit në kripë”. Edhe këtu nuk kemi propozim.

Në pikën 4 kemi propozimin e zotit Baraj që shpenzimet për marrjen e mostrave të nevojshme për kontrollin e kripës së jodizuar të përballohen nga subjekte prodhuese. Zoti Baraj propozon të përballohen nga vetë institucionet shtetërore. Ky është një ndryshim. Në pikën 3 zoti Beqaj propozon që të hiqet gjysma e fjalisë së fundit, pra: “Inspektimi për kripën e jonizuar (për nivelin e jodit në kripë) kryhet nga struktura përgjegjëse për inspektimin shëndetësor në bazë të planifikimit, vlerësimit të riskut, raporteve të monitorimit dhe

sinjalizimet nga burimet e tjera”. Pra të hiqet “nga strukturat rajonale”, sepse biem në përsëritje. Këto ishin propozimet.

Atëherë, e hedhim në votë variantin me propozimin e zotit Baraj dhe pa propozimin e zotit Baraj? Pra, të gjitha ndryshimet që përmenda fillimisht pa propozimin e zotit Baraj, siç janë sot. Kush është dakord me ndryshimin e variantit të Ministrisë së Shëndetësisë, pa amendamentin e zotit Baraj? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet varianti i Ministrisë së Shëndetësisë me disa ndryshime që nuk po i lexoj përsëri. Nuk miratohet amendamenti i zotit Baraj për pjesën e shpenzimeve të kryerjes së analizave të mostrës.

Vazhdojmë me nenin 12/1, që shtohet pas nenit 12. Edhe këtu kemi riformulim nga ministria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kalojmë te neni 6.

Po, Xhilda, më thuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Mbetet neni 6 dhe hiqet neni 7.

Niko Peleshi – Neni 5. Ju lutem lexoni variantin e propozuar nga Ministria e shëndetësisë. Neni 5 riformulon nenin 13, si më poshtë: “Monitorimi i “kripës së jonizuar” (propozimi është që të themi “nivelit të jodit në kripë”) në pikat e prodhimit në vend, në ato të importimit dhe në pikat e shitjes me pakicë dhe shumicë kryhet nga strukturat rajonale dhe/ose vendore të shëndetësisë në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e tyre”.

2. Monitorimi është procesi sistematik i mbledhjes së mostrave të kripës së jodizuar, analizimit dhe përdorimit të informacionit, me qëllim sigurimin e nivelit të jodit në kripë e të tjera.

3. Prodhuesi i kripës së jodizuar në vend dhe importuesi i saj janë përgjegjës për nivelin e jodit në kripë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eglantina Gjermani – Sipas propozimit të ministrisë, mendoj se dyshi duhet të dalë para, sepse përcakton se çfarë është monitorimi, pastaj cili e kryen monitorimin.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Shërbimet e komisionit duhet ta kenë parasysh si propozim që të mos na dalë nga mendja, në qoftë se më lejon, zonja Gjermani, për ta ritheksuar edhe një herë

propozimin: pika 2 të hiqet fare dhe të futet në fillim te përkufizimet, sepse është përkufizim. Neni 1 mbetet 1, pika 2 kalon te përkufizimet dhe pika 3 bëhet pika 2.

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, propozimi: pika 2 bëhet 1 dhe pika 1 bëhet 2.

Urdhëroni!

Ilir Beqaj – Domethënë: “kryhet nga strukturat rajonale dhe/ose vendore të shëndetësisë”. Si thoni, ose njëra, ose tjetra? Hiqeni “dh”-në dhe lëreni vetëm “ose”.

Niko Peleshi – Keni të drejtë.

U mbajt shënim propozimi. A ka propozime të tjera?

Kush është dakord me nenin 5 të riformuluar nga Ministria e Shëndetësisë me këto ndryshime: te koka e nenit 13, në vend të themi “monitorimi i kripës së jonizuar”, të themi “monitorimi i nivelit të jodit në kripë”; pika 1 bëhet pika 2, ndërkohë pika 2 vjen më sipër dhe bëhet pika 1 dhe qëndron siç është; te pika 2, që aktualisht është pika 1, hiqet lidhëza “dhe” dhe lihet vetëm “ose”, pra “strukturat rajonale ose vendore të shëndetësisë”.

Pika 3 ndryshon si më poshtë: “Prodhuesi i kripës së jodizuar në vend dhe importuesi i saj janë përgjegjës për nivelin e jodit në kripë” dhe jo “për cilësinë e kripës së jodizuar”.

Kush është dakord me këto ndryshime? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 6.

Në nenin 6 kemi riformulim nga Ministria e Shëndetësisë, gjithashtu. Do të punojmë mbi variantin e ministrisë?

Neni 6 riformulohet propozon të ndryshohet si më poshtë: “Pas nenit 13/1 shtohet neni 13/2 me këtë përmbajtje. Neni 13/2: “Kërkesat për gjurmueshmërinë e kripës për konsum human, shtazor dhe përdorim në industrinë ushqimore. Operatori i biznesit ushqimor krijon dhe mban informacionin e nevojshëm për gjurmueshmërinë në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit, jodizimit të kripës dhe shpërndarjes së saj. Informacioni i nevojshëm për gjurmueshmërinë përfshin këto të dhëna:

a) identifikimin e çdo subjekti tregtar personi juridik apo fizik, nga i cili operatori i biznesit ushqimor është furnizuar me kripë;

b) identifikimin e çdo subjekti tregtar, të cilin operatori i biznesit ushqimor e ka furnizuar me kripë të jodizuar.

c) sasinë e kripës së furnizuar dhe nivelin e jodit në nivelin e furnizimit;

d) datën e skadencës së kripës së furnizimit.

Pika 3 operatori i biznesit ushqimor ruan të dhënat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni për jo më pak se 3 vjet dhe siguron që këto të dhëna t'i jepen menjëherë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe inspektoratit përgjegjës për shëndetësinë.

4. Kripa ushqimore e nxjerrë në treg ose që mund të nxirret në treg mund të etiketohet ose të identifikohet nëpërmjet dokumenteve për çdolloj informacioni tjetër për të siguruar gjurmueshmërinë.

Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Kam diçka të vogël për titullin e nenit. Diku më parë thamë “konsum njerëzor” dhe jo “konsum human”, thjesht për të qenë konsistentë me shprehjet që përdorim, sepse në një nen tjetër e kishit “për konsum njerëzor”. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Së dyti, a mund ta ndryshojmë fjalën “konsum” me fjalën “përdorim”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, tërhiqem.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi – Në këtë nen janë të gjitha detyrimet që i lindin operatorit dhe, normalisht, më duken lehtësisht të bëshme, sepse është fjala për një bar-kod që do ta ketë dhe brenda atij bar-kodi i ka të gjitha të dhënat që duhet të ruaj. Ajo që unë...

Niko Peleshi – Nuk thotë për bar-kod, por nëse.

Arben Pëllumbi – Është dokumentacion. Pse duhen 3 vjet që t'i ruaj të dhënat kur problemin e jodit ose e ke 6 muaj ose, po nuk e pate, për çfarë të duhet për 3 vjet, pra çfarë ka ndodhur para 3 vjetësh?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Urdhëroni!

Roland Kristo – Zakonisht çfarëdolloj e dhëne ruhet në institucione. Afati minimal është 3-vjeçar për të gjitha llojet e të dhënave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, ruhen të dhënat për 3 vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo vetëm në Shqipëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Zoti zëvendësministër, unë e kuptoj, por roli juaj në këtë aspekt përjashtohet. Ju nuk keni lidhje me këtë, kanë lidhje këta të Ministrisë së Shëndetësisë. Pse këtyre u duhet që biznesi t'i ruajë 3 vjet të dhënat?

Ilir Beqaj – Sepse 3 ka qenë te ligji ekzistues.

Arben Pëllumbi – Pse 4 dhe jo 2? Pse 3 vjet? Vetëm për këtë që thatë ju, që 3 vjet është e përgjithshmja xhenerike për çdo ruajtje të të dhënave?

Niko Peleshi – Po i hymë këtij diskutimi, do të themi: sa ta lëmë 2? Pse 2?

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, kush është dakord me këtë nen, siç është formuluar nga Ministria e Shëndetësisë, me ndryshimin e fjalëve “konsum human”, në “konsum njerëzor”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tjetër gjë, nuk kemi.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet sipas variantit të propozuar së fundi nga Ministria e Shëndetësisë.

Zoti Baraj ka kërkuar fjalën.

Besnik Baraj - Një nga problemet kryesore të kripës që shitet është sigurimi i qëndrueshmërisë së jodit në kripë, sepse dihet që me kalimin e kohës ka procese të ndryshme kimike, që mund të bëjnë të largohet. Jodi është një shqetësim shumë i madh në Shqipëri. Ndërkohë, ne nuk përcaktojmë me ligj kushtet e tregtimit të kripës, që të minimizojmë humbjen e jodit. Është e provuar, mund t’ju tregoj edhe artikullin, që jodi bie brenda një kohe të shkurtër në shitjen me ambalazhe kartoni, letre, që kanë aftësi absorbuese dhe lagështi. Është provuar se kur produkti ruhet në shishe qelqi ose në ambalazh të veshur brenda me plastikë, edhe pas 6 apo 8 muajsh nuk ka humbje të jodit, është e njëjta sasi. Këtë mund t’ju provoj me ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mos përdorin materiale që kanë kapacitet absorbues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mua më thanë që tregtohet edhe në materiale letre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai që e çon në treg, unë nuk besoj se ...

(Mungesë incizimi)

Roland Kristo – Normalisht, ky ligj do të merret me kontrollin e të gjithë zinxhirit, nga prodhimi deri te hedhja në treg. Natyrisht, edhe kripa që ndodhet nëpër raftet e supermarketeve është objekt i kontrollit. Në rast se nuk përputhet data e skadencës, që kripa duhet të jetojë 6 muaj me nivelin e jodit, kthehet mbrapsht dhe subjekti penalizohet nëse nuk e ka paketuar sipas standardit. Është objekt kontrolli edhe në supermarkete.

(Mungesë incizimi)

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Atëherë, kalojmë te neni 7.

Neni 7 hiqet, sepse u integrua te neni 6.

Para se të kalojmë te neni 8, i cili prek nenin 21, po i referohem amendamentit të zotit Balla dhe propozimit të Ministrisë së Bujqësisë për nenin 17. Ministria e Shëndetësisë thotë: “Në projektligj nuk janë parashikuar ndryshime në kundërvajtjen administrative. Edhe pse në projektligj importi dhe përdorimi lejohen, neni 17 e parashikon si shkelje administrative”. Për këtë qëllim, pikat 1 dhe 2 të nenit 17 duhet të riformulohen si më poshtë:

Kundërvajtje administrative: Kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative, shkeljet e mëposhtme. Kjo duhet ndryshuar, sepse thuhet: “Importi, prodhimi, shpërndarja, tregtimi apo marketimi i kripës së pajodizuar ose me nivel jodi më të përcaktuar për konsum njerëzor shtazor...”, duhet shtuar “me përjashtim të rasteve të parashikuara me këtë ligj”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozohet të shtohet neni 7, i cili riformulon nenin 17. Te neni 17 shtohen “me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj”, sepse ne parashikuam disa raste përjashtimore, të cilat vazhdojnë të jenë ndëshkime në nenin 17.

Në pikën 2: “Përdorimi i kripës së pajodizuar ose kripës së jodizuar në nivel më të ulët...” thuhet: “me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj.

Kush është dakord të shtohet neni 7 me këtë përmbajtje? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8 ka lidhje me pikën 2 të nenit 21. Pas fjalëve të nenit 11 shtohen edhe të pikës 3 të nenit 12/1. Ky është neni 8. Nuk ka propozime për ndryshim, por duhet të presim sa të hyj Iliri, që të kemi numrin.

(Diskutime pa mikrofon)

(Mungesë incizimi)

Neni 8 mund të jetë i panevojshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne po e miratojmë. Nëse del i panevojshëm në raport, për komisionin përgjegjës, t'i propozohet komisionit për ta hequr.

Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9 “Hyrja në fuqi” 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Ilir Beqaj – A nuk duhet t’u lëmë më shumë kohë subjekteve, sepse u votua ... Domethënë, mos ndodhin probleme që ndikojnë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Kristo – Vetëm përfitojnë, nuk humbasin asgjë.

Ilir Beqaj – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos e merrni aq lehtë, sepse kemi detajuar më shumë gjurmueshmëri. Duhet të bëhen gati me një sistem gjurmueshmërie. Më pas ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj - Dakord.

Unë këtë merak kam, por nëse ...

Niko Peleshi – Ilir, nuk fola te gjurmueshmëria për të mos u grindur, sepse nuk prish punë, por nuk kemi shtuar ndonjë gjë për gjurmueshmërinë. Gjurmueshmëria, e përcaktuar si në këtë ligj, është sot në ligjin e ushqimit, apo jo?

Ilir Beqaj – Jo.

E kam parë me detaje. Në ligjin e ushqimit sot kemi vetëm nga e merr, nuk kemi ku e çon dhe ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di, sepse jam marrë me detaje. Edhe vendimi i vitit 2015 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e shteron.

Nëse duam të rrimë te viti 2015, t’i anulojmë, sepse atë pjesë e zgjidh projekti i ri i fiskalizimit. Faturë në hyrje, faturë në dalje, nuk është gjurmueshmëri, sepse nuk ka datë skadence te vendimi i vitit 2015.

Person – Cili është propozimi?

Ilir Beqaj – Kemi shtuar ...

Person – Cili është propozimi për hyrjen në fuqi?

Ilir Beqaj – Nëse ministria thotë: “Nuk ka efekt”, unë tërhiqem.

Niko Peleshi – Dakord.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, të ndryshuar””? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Komisioni përgjegjës është Komisioni i Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë. Ne do t'i çojmë raportin pasi të zbardhet dhe do t'i kërkojmë të deleguarit të këtij komisioni, zotit Pendavinji, të merren parasysh propozimet tona, sepse kanë qenë shumë skrupuloze dhe shumë të situara nga diskutimet e anëtarëve të komisionit.

Kjo seancë mbyllet me sukses.

Faleminderit!